MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE

Delegacioni
i Komisionit Europian

JACOBS

LOUIS BERGER S.A.

QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



# PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS

## *Komuna Shëngjin*

*për një komunitet të shëndetshëm*
*në mjedis të shëndetshëm*



# Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

## Komuna Shëngjin

**Përgatitur në kuadër të projektit CARDS "Legjislacioni dhe Planifikimi Mjedisor në Shqipëri - ELPA" Financuar nga Komisioni i Delegacionit European, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Zbatuar nga Jacobs, Louis Berger S.A dhe Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri**

**Viti i botimit 2006**
**Shtypur pranë shtypshkronjës Gent Grafik, Tiranë**

**Ky dokument është përgatitur me ndihmesën e:**

**QENDRA RAJONALE E MJEDISIT**
Shqipëri

http://albania.rec.org

Në bashkëpunim të ngushtë me:
Komunën Shëngjin, drejtoritë dhe inspektoriatet që veprojnë në komunë, ekpertë rajonalë dhe të projektit ELPA

dhe me kontributin e:

Alken Myftiu, Bardhok Ndreca, Daniela Tola, Eduart Cani, Gjergj Gjoni, Gjergj Kqira, Jak Gjini, Luigj Kola, Mihallaq Qirjo, Pashk Smaçi, Robert Selimi

## A. Parathënie

Ky dokument është përgatitur ne kuadër të projekti CARDS "Legjislacioni dhe Planifikimi Mjedisor në Shqipëri (komponenti i planfikimit mjedisor)". Qëllimi kryesor i ELPA është të mbështesë objektivat e Qeverisë shqiptare në përmbushjen e principeve të zhvillimit të qëndrueshëm në përputhje me bisedimet për futjen në BE. Kjo përfshin forcimin e kapaciteteve teknike dhe administrative të qeverisjes vendore dhe ngritjen e kapaciteteve në proceset e hartimit të Planeve Mjedisore në nivel rajonal dhe vendor.

PLVM është i lidhur ngushtësisht me komponentët e tjerë te projektit ELPA:

- Strategjia Kombetare e Mjedisit përcakton politikat për të gjithë sektorët e zhvillimit duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve mjedisore të përdorura për zhvillim si dhe mbrojtjen e larmisë biologjike.
- Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis pë deltën e lumit Drin (Shkodër - Lezhë);
- Planin pilot të bregut nga derdhja e lumit Ishëm deri në derdhjen e lumit Buna;
- Ngritjen e ndërgjegjes mjedisore në nivelet rajonale dhe vendore. Procesi i konsultimeve publike të ndërmarra në kuadër të PLVM është në një linjë me legjislacionin e BE për planet e zhvillimit.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është në linjë me përpjekjet e qeverisë shqiptare për forcimin e mëtejshëm të proceseve të planifikimit mjedisor në të gjitha nivelet ashtu si kërkohet dhe nga Procesi i Asocim-Stabilizimit dhe Brenda projektit ELPA, si një ndihmesë në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Mjedisit.

Qëllimi i këtij dokumenti është të adresojë the zhvillimin e paplanifikuar, zhvillimin e shpejtë të nismës private e shoqëruar me ndërhyrje të pakontrolluara në infrastrukturën ekzistuese, e cila ka ndikuar negativisht në natyrë dhe në shëndetin e popullatës. Në shtesë të kësaj, krijimi i qendrave të reja të banuara, ka rritur presionin mbi infrastrukturën e pazhvilluar të zonës. Zbritja e popullsisë nga zonat malore ka gjendur të paërgatitur autoritetet vendore dhe ka cuar në zhvillime kaotike në të gjithë zonën, si dhe rritje të problemeve të turizmit në zonën bregdetare.

Duke marrë në konsideratë mungesën e sistemeve të kontrollit dhe ndërgjegjësimin e ulët të fushës së biznesit, insitucioneve dhe komunitetit për çështjet e mjedisit, projekti ka punuar në përfshirjen e mjedisit në axhendën e përditëshme të autoriteteve vendore dhe ka forcuar mënyrat dhe metodat e komunikimit me publikun në dobi të pjesmarrjes dhe vendimmarrjes për cështjet mjedisore

Grumbullimi i të dhënave të disiplinave të ndryshme në komunë, duke filluar nga veçoritë fiziko - gjeografike, trualli, pasuritë natyrore dhe nëntokësore, uji, bujqësia, biodiversiteti, pyjet, peshkimi, hidro - gjeologjia të dhëna demografike, përdorimi i terreneve, energjia, mbetjet urbane, edukimi etj., pasi kaluan në disa stade diskutimi dhe përmirësimi, janë konceptuar në një dokument të integruar me një fokus të qartë të mbrojtjes së natyrës.

Dokumenti sjell një analizë të të dhënave të 50 viteve të fundit në disiplina të ndryshme sipas kushteve të ndryshme të relievit të kësaj zone (rrafshina detare, liqenore, ultësira pranë - adriatike, lugina e kanione të ndryshme, laguna, etj). Plani Lokal Mjedisor i

## Shkurtime

**ELPA** ------------------Projekti "Legjkislacioni dhe Planfikimi Mjedisor në Shqipëri
**REC** --------------------Qendra Rajonale e Mjedisit
**MMPAU** ---------------Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave
**KRRTSH** --------------Këshilli i Rrergullimit të Territorit të Shqipërisë
**DSHP** ------------------Drejtoria e Shërbimit Pyjor
**MPÇS** ------------------Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale
**MPPTT** ----------------Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
**KQ** ---------------------Këshilli i Qarkut
**NBO** -------------------Nevoja Biologjike për Oksigjen
**IUCN** ------------------Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
**OJF** --------------------Organizata Jofitimprurëse
**ARM** -------------------Agjencia Rajonale e Mjedisit

zonës që mbulon të gjithë komunën Shëngjin, ishte një ndërmarrje e vështirë, por me interes të madh. I zbërthyer në kapitujt bazë të analizës së gjendjes, rekomandimeve dhe planit të veprimeve, ai sjell një vizion të ri zhvillimit ndërdisplinor në Shqipëri, fushat e ndryshme me ndikim të ndërsjelltë, janë sjellë në mënyrë të harmonizuar dhe në respekt të natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Dokumenti pritet ti shërbejë autoriteteve qendrore dhe vendore, biznesit, organizatave të ndryshme, specialistëve dhe grupeve të tjera të interesuara, për të zhvilluar më tej vizionet e tij për një zhvillim me bazë përdorimin e pasurive natyrore në mënyrë të qëndrueshme në komunën e Shëngjinit.

## B. Procesi dhe metodologjia

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për komunën Shëngjin, është hartuar nga specialistë vendorë të kësaj komune, ekspertëve kombëtarë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, si dhe me ndihmën e ekspertëve të Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) dhe atyre ndërkombëtarë nga projekti ELPA.
I zhvilluar në tre pjesë kryesore, PLVM është konceptuar në kapitujt kryesorë: Analiza e situatës, Rekomandime dhe strategjia për zhvillim, dhe Plani i Veprimit. Duke u kujdesur në mënyrë të vecantë në ndërveprimet ndërmjet çështjeve të ndryshme, për secilën çështje paraqitet problematika, rekomandimet dhe ndërhyrjet konkrete. Kështu, dokumenti trajtohet në një rrjedhjë logjike, ku së pari përcaktohet dhe analizohet problemi, dhe më pas jepen rrugët e mundëshme të zgjidhjes.
Një nga hallkat më të rëndësishme të procesit ka qenë diskutimi i gjetjeve dhe përfundimeve të dokumentit me një numër të konsiderueshëm specialistësh vendorë dhe përfaqësues të komunitetit në të dy rajonet. Me qëllimin e përgatitjes së një dokumenti gjithëpërfshirës, janë ndërmarrë një sërë veprimtarish për konsultimin publik, nëpërmjet takimeve publike, tavolinave të diskutimit dhe thirrjes për bashkëpunim.
Ekipi i projektit ELPA dhe REC Shqipëri dëshirojnë të falenderojnë aktorët lokalë dhe rajonalë të përfshirë në këtë proces për mbështetjen dhe angazhimin e tyre në hartimin e PLVM, si modeli dhe prototipi i parë në Shqipëri.

## Përmbajtja

**A-B. Parathënie**
**C. Analiza e përgjithshme e mundësive dhe pengesave në zhvillimin e komunës Shëngjin ....................... 11**
**1. Përshkrim i i përgjithshëm i komunës ........................................ 13**
1.1 Përshkrimi i njësive administrative dhe demografisë
1.2 Klima
1.3 Tendecat e zhvillimit
1.4. Zonimi sipas kategorive të tokës dhe rëndësisë

**2. Aktiviteti njerëzor dhe shërbimet ................................................ 21**
2.1. Punësimi, të ardhurat, biznesi
2.2. Shërbimet
2.3 Aktiviteti bujqësor

**3. Burimet natyrore dhe zonat e mbrojtura .................................. 33**
3.1 Zonat e mbrojtura
3.2. Pyjet
3.3. Dunat ranore
3.4. Menaxhimi i zonave te mbrojtura
3.5. Erozioni bregdetar
3.6. Çështje të pejsazhit
3.7. Menaxhimi i ujrave dhe përmbytjet

**4. Turizmi dhe edukimi i komunitetit ............................................. 43**
4.1. Vlerësim i përgjithshëm

**5. Lista e problemeve ............................................................................ 45**

**6. Vlerësimi i mundësive – Rekomandimet .................................... 57**

**7. Plani i Veprimeve ............................................................................ 67**

**Harta ........................................................................................................ 81**

## C. Analiza e përgjithshme e mundësive dhe pengesave në zhvillimin e komunës Shëngjin

Ky ushtrim është zhvilluar me grupet e punës të ngritura pranë Komunës Shëngjin, me qëllim nxjerrjen në pah të elementëve që i japin mundësi kësaj zone me pasuri të mëdha natyrore që të zhvillohet më tej dret parametrave të një rritje të qëndrueshme, si dhe të marrë nën mbikëqyrje, me qëllim menaxhimin e tyre, rreziqet dhe pengesat që e ngadalsojnë zhvillimin.
Ky ushtrim tenton të jetë gjithmonë i diskutueshëm dhe në nevojë për ribërje në mënyrë periodike, duke i dhënë mundësi vendimmarrësve dhe sipërmarrësve që të gjëjnë veten në përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre në të mirë të zhvillimit.

| Anët e forta | Mundësitë |
|---|---|
| Pozicioni gjeografik<br>Kapacitetet njerëzore<br>Prania e Porti detar<br>Burimet natyrore (lagunat, etj)<br>Afërsia me rrugen kombëtare | Zhvillim i turizmit<br>Zhvillim tregtar i zones<br>Peshkimi si aktivitet<br>Përpunimi i produkteve bujqesore<br>Mundesite e zhvillimit te infrastructures që lidhen me sistemin rrugor |
| **Anët e dobëta** | **Rreziqet** |
| Zhvillimi i pa kontrolluar i ndërtimeve pa leje<br>Mungesa e master planeve dhe planeve rregulluese<br>Sipërfaqe e vogël e komunës<br>Mungesa e shërbimeve per banoret (uji i pijshëm, manaxhimi i mbetjeve, etj) | Erozioni lartë i bregdetit dhe tokës<br>Përmbytjet (Drini, Ishull Lezhë, etj)<br>Sizmiciteti i lartë |

# 1. Përshkrim i i përgjithshëm i komunës

*(Relievi, klima, demografia, zhvillimi, etj)*

## 1.1 Përshkrimi i njësive administrative dhe demografisë

Komuna Shëngjin është një ndër njesitë administrative më të rëndësishme të Qarkut Lezhë, me qytetin e Shëngjinit qendër turistike dhe portuale mjaft tërheqëse, relievin plot variacione, ku harmonizohet bukuria e kaltërsisë së detit dhe shkëlqimit të diellit mbi plazhin e madh, me hijen e malit të Rencit, pylli i pishave me dunat e rërës dhe bimësinë e ligatinave, në të cilat jetojnë gjallesa nga më të ndryshmet e sidomos shpendët e shumtë me përmasa dhe ngjyra të larmishme.
Shëngjini, qytet dhe port detar, plazh i madh shtrihet 8 km në veriperëndim të qytetit të Lezhës, rrëzë të shpatit të thepisur të malit të Rencit. Zona rrethohet nga ligatina, laguna e Kenallës, Kunë-Vainit, e Kashtës, Merxhanit, Cekës, Kularit, Gjoli i Buajve, etj.

Relievi është kryesisht fushor, nga 1-2 m mbi nivelin e detit deri në rreth 550 m (Maja e Zezë në kodrën e Rencit). Nuk mungojnë edhe sektorë në të njëjtin nivel me detin ose edhe poshtë tij gjë që ka sjellë formimin e lagunave, kënetave apo moçaleve. Qyteti i Shëngjinit në antikitet njihej me emrin Nimphaeum dhe është krijuar afërsisht në të njëjtën kohë me Lisin (shek.IV para erës sonë) ku u zhvillua si port i qytetit Ilir e me pas Romak

Komuna Shëngjin me një gjatësi vije bregdetare prej 13 km, si njësi administrative është e përbërë nga qyteti i Shëngjinit, dhe katër fshatra, Ishull Shëngjin, Ishull Lezhë, Mali i Rencit dhe Mali Shëngjin.

Qendër administrative është qyteti Shëngjin dhe dendësia e popullsisë është 195.4 banorë/km$^2$. Komuna ka një popullsi prej 10552 banorë (10.87% e popullsisë së Lezhës) nga të cilët 5229 (49.55%) femra me 2677 familje që shtrihet në një siperfaqe prej 54 km2. Popullsia në zonën urbane (Shëngjin qytet) është 33.70 % dhe në zonën rurale është 66.30 % . (harte administrative)

Popullsia e Shëngjinit ,(në vitin 1990 me 7000 banorë) nga viti 1990 -2005 është rritur me 50.74 % (ose 3552 banorë), një nga rritjet më të mëdha në Lezhë. Banorët e ardhur janë kryesisht nga zonat malore të Mirditës, Shkodrës, Malësisë së Madhe, Tropojës, Pukës, etj.

Rreth 32 % e popullsisë është nën moshën 15 vjeç apo 55.9 % është nën moshën 30 vjeç, ndërsa vetëm 7% është mbi 65 vjeç.Sasia e lindjeve gjatë muajit Dhjetor 2005 ka qënë 8 fëmijë dhë sasia e vdekshmërisë nën 1 vjeç ishte 0 fëmijë. Vetëm brenda vitit 2005 shtimi i popullsisë së Komunës ishte me 346 banorë.

## 1.2 Klima

Nga pikëpamja klimatike Shëngjini karakterizohet nga klima mesdhetare me verë të nxehtë dhe dimër të lagët. Temperatura mesatare vjetore arrin 16$^0$C ku temperatura mesatare në dimër është 7 $^0$C ndërsa në verë 25 $^0$C. Numri i ditëve me diell është 230 deri në 250 ditë në vit.

*Tabela 1. Temperaturat mesatare mujore për 20 vitet e fundit. (Burimi: Komuna Shëngjin)*

| Vitet | Muajt | | | | | | | | | | | | Tem. mesa-tare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Janar | shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | |
| 1984-1994 | 6,7 | 8,5 | 10,5 | 13,5 | 18 | 21 | 23,6 | 25,5 | 20,9 | 16,9 | 12 | 8,3 | 15,4 |
| 1995-2005 | 8,1 | 9 | 11,2 | 14,5 | 18,7 | 22,4 | 24,9 | 25 | 22 | 18 | 13,7 | 10 | 16,5 |

Sic vihet re nga tabela, ka një rritje mesatare të temperaturës prej 1 grade, e cila mund te kërkojë një analizim më të hollësishëm për të parë pasojat që mund të ketë sjellë në të ardhmen.

*Tabela 2. Sasia e reshjeve në mm për 30 vitet e fundit:*

| Vitet | Muajt | | | | | | | | | | | | Mes. Vjetore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | |
| ‘73-’83 | 198 | 173 | 172 | 100 | 113 | 87 | 36 | 49 | 92 | 203 | 210 | 210 | 1.643 |
| ‘84-’94 | 134 | 146 | 155 | 131 | 115 | 68 | 45 | 80 | 110 | 180 | 218 | 180 | 1.592 |
| ‘95-’05 | 174 | 148 | 138 | 121 | 98 | 78 | 38 | 54 | 190 | 152 | 94 | 175 | 1.463 |

Sasia mesatare vjetore e reshjeve shkon nga 1500 -1700 mm. Nga analiza e të dhënave mbi reshjet vihet re që reshjet nuk e kanë shtuar intensitetin e tyre në vitet e fundit, ndërkohe që rastet e përpbytjeve kanë qënë të mëdha vitet e fundit

## 1.3 Tendecat e zhvillimit

Mungesa e masterplaneve dhe e planeve rregullues kanë sjellë shumë probleme si për lëvizjen demografike ashtu edhe për ndërtimet e pastudiuara në zonën turistike sipas parametrave të kërkuar. Numri i banesave familjare është rreth 2020. Qyteti po pëson një zhvillim të shpejtë, duke u bërë një ndërthurrje qendre urbane dhe qendrash turistike në rritje. Në tabelën 3, tregohen statistikat për numrin e banorëve dhe kapacitetin e akomodimit të turistëve për komunën, qytetin dhe fshatrat e tjera.

Vlerësohet se aktualisht ka mundësi akomodimi për rreth 4.000 banorë në ditë gjatë kulmit turistik të periudhës së verës. Studimi i Zhvillimit për Shkodrën dhe Lezhën vlerëson se popullsia totale e komunës së Shëngjinit do të rritet me rreth 10500 banorë dhe një numër shtesë prej rreth 8000 pushuesish në vitin 2020. Nga shifrat e mësipërme, vlerësohet se qyteti i Shëngjinit do të tërheqë rreth 8.000 banorë vendas dhe 8.000 pushues, duke arritur kështu një numër banorësh prej 26.000 – rezidentë dhe pushues – gjatë kulmit të sezonit të verës. Qyteti po përballet me trysni të fortë për zhvillimin e ndërtimeve për banesa, duke përfshirë strehim për të ardhurit e rinj në

këtë zonë, për turistët, dhe apartamente në shitje si shtëpi të dyta. Pylli me pisha dhe plazhi me duna rëre në jug të qytetit tashmë vizitohen në verë, kryesisht nga vizitorët familjarë ditorë nga qytetet përreth.

*Tabela 3. Ndryshimi i popullsisë sipas Regjistrit Civil dhe parashikimi i popullsisë për 2020 (Burimi: projekti EPTISA[1)])*

| Njësitë administrative | Viti 2003 | Viti 2005 | Projektimi për 2020 |
|---|---|---|---|
| Komuna Shëngjin | 10120 | 10206 | 28767 |

*Tabela 2. Vlerësimi i ndryshimit të popullsisë dhe pushuesve[2)]*

| | Popullsia në vitin 2005 | Shtimi i popullsisë deri në vitin 2020 | Popullsia në vitin 2020 | Zona e për-gjithshme "urbane" | Dendësia bruto e popullsisë |
|---|---|---|---|---|---|
| | Banorë vendas dhe pushues | Banorë vendas dhe pushues | Banorë vendas dhe pushues | | |
| **Fshati Hyrës Turistik Ishull-Lezhë** | 1,000 + 200 | 1,500 + 2,300 | 5,000 | 68 ha | 74 banorë/ha |
| **Qendra Turistike e Shëngjinit** | 6,000 + 4,000 | 8,800 + 8,150 | 26,950 | 135 ha | 200 banorë/ha |
| **Qyteti "Ekzistues"** | 5,500 + 3,500 | 3,800 + 3,000 | 15,800 | 50 ha | 320 banorë /ha |
| **Qyteti "I Ri"** | 500 + 500 | 5,000 + 5,150 | 11,150 | 85 ha | 130 banorë/ha |

*Grafik 1. Rritja e popullsisë nga viti 1990 - 2005 për disa nga komunat e Qarkut Lezhë dhe Bashkisë Lezhë. (Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, 2005)*

1 Parashikim i bërë nga projekti "Studimi për Zhvillimin Rajonal (Eptisa)"
Shënime të përgjitshme: Shifrat e përgjithshme në nivelin e komunës për vitin 2005 dhe parashikimet deri në vitin 2020 janë marrë nga të dhënat e mbledhura nga Studimi për Zhvillimin Rajonal (SZHR) për zonat e Lezhës dhe të Shkodrës, të përfunduara së hartuari nga këshilltarët e EPTISA (Spanjë) dhe të financuar nga programi CARDS I BE-së për Shqipërinë.

2 Vlerësim i bërë nga projekti ELPA, në kuadër të Planit Pilot për zonën bregdetare, Lumi Ishëm - derdhja e Lumit Buna.




Në nevojën për një masterplan të zhvillimit, kërkohet përcaktimi i disa koncepteve, të cilat do të mund të ndalojnë një herë e mirë zhvillimin e pakontrolluar dhe ti japë Shëngjinit më shumë mundësi rritje ekonomike. Rrjedhimiosht ky koncept zhvillimi urban bazohet në këto parime kryesore:

- Zonat urbane brenda kufijve ekzistues të qytetit duhet të konsolidohen dhe të ristrukturohen;
- Zhvillimi i mëtejshëm urban jo i planifikuar jashtë zonave të përcaktuara nuk duhet të lejohet dhe veçanërisht në pyjet bregdetare me pisha përreth qytetit, të cilat duhet të rehabilitohen;
- Nuk duhet të lejohet zgjerimi i zonave të përziera urbane dhe turistike në jug drejt Lagunës së Kunës. Zhvillimi i ri urban duhet të kufizohet brenda zgjerimit urban të propozuar në lindje;
- Vizioni për Shëngjinin përfshin qëndra turistike informale të përqendruara në port dhe në plazh. Me kalimin e kohës, Shëngjini duhet të hyjë në konkurrencë me qytetet e tjera të vogla në Mesdhe, të cilat ndërthurrin veprimtaritë detare me turizmin. Elementet kryesore të planit për Shëngjinin përfshijnë: i) Të shfrytëzohet sa më shumë porti dhe zona ushtarake në kufirin verior të qytetit, duke i kthyer ato në një "zonë bregdetare" të integruar me një gamë atraksionesh dhe veprimtarish që lidhen me portin dhe detin. Kjo do të bëhet zona kryesore me interes për vizitorët dhe ajo do të përfshijë: një qendër informacioni për vizitorët; një port të vogël varkash dhe një flotë peshkimi, një numër më të madh restorantesh me asortimente peshku, një numër më të madh atraksionesh bregdetare, si dhe përfshirjen e planifikuar të akomodimit dhe veprimtarive të argëtimit në këtë zonë; ii) Të arrihet një zhvillim më i kujdesshëm urban për të krijuar një imazh më të fortë urban me më shumë lehtësira dhe komoditete, të mbështetura nga një pastrim, mirëmbajtje dhe menaxhim më i mirë; iii) Të forcohen lidhjet me pyllin dhe malin pas qytetit, duke përfshirë këtu përdorimin e një pjese të tij për të krijuar një park pyjor; iv) Të përmirësohen lehtësirat dhe menaxhimi i plazhit urban duke ndërtuar një shëtitore të përhershme për kalimtarë dhe duke parandaluar zhvillimin e mëtejshëm urban që cënon zonën e plazhit; v) Të sistemohet zhvillimi i ri urban në lindje të qytetit në rrugën e Lezhës duke mbushur sipërfaqe me një nivel të ulët; vi) Të ruhet Liqeni i vogël (pellgu) i Kenallës si një tipar dallues i peisazhit;

vii) Të kufizohet zhvillimi i mëtejshëm urban në jug të qytetit në mënyrë që të mbrohet Laguna Kune, e cila ndodhet pranë qytetit, dhe të ristrukturohet hyrja me anë të rrugës në mënyrë që ajo t'i shërbejë zhvillimit urban me dendësi të ulët, si dhe të krijohet një zonë e rezervuar me lehtësira brenda sipërfaqes me pisha që shtrihet përgjatë bregut; viii) Të rehabilitohet pylli i pishave përgjatë bregdetit; ix) Të nxitet hyrja në plazh dhe në pyllin që shtrihet në jug jo me makinë, por në mënyra të tjera, si pjesë e atraksioneve për vizitorët; x) Tregu kryesor i turizmit do të vazhdojë të jenë familjet nga trojet me popullsi etnike shqiptare, të cilat vijnë për të kaluar pushimet në bregdet. Një treg i ri do të jenë edhe turistët qe do të vijnë për pushime të shkurtra gjatë sezoneve të ndryshme, të cilët do të tërhiqen jo vetëm nga plazhi, por edhe nga qendra bregdetare, restorantet e peshkut dhe nga një gamë e gjerë veprimtarish. Teksa kjo zonë do të përmirësohet, ajo do të jetë e pozicionuar më mirë për të tërhequr vizitorë ditorë të cilët janë të gatshëm të shpenzojnë më shumë. Me kalimin e kohës, Shëngjini mund të ketë potencialin për të tërhequr anije të vogla lundrimi dhe varka turistike. Vizitorët e huaj që tashmë e vizitojnë Shqipërinë mund të tërhiqen nga peisazhet bregdetare dhe ato të Malit të Rencit, si dhe sipërfaqja e gjerë e moçaleve.

- Hapësira për zhvillim të ri urban në qytet është relativisht e kufizuar. Shëngjini ka tashmë disa hotele dhe përparësia kryesore duhet të jetë përditësimi i atyre hoteleve ekzistuese dhe i mjedisit urban. Zhvillimi i ri benda qendrës së qytetit dhe zgjerimit në lindje mund të përfshijë: i) Pesë deri në dhjetë hotele të vogla; ii) Ndoshta një hotel të madh; iii) Ndoshta një kompleks pushimesh; iii) Më tepër apartamente të menaxhuara; iv) Një hapësirë kampingu.

- Gjithashtu, përveç plazhit, kësaj zone i mungojnë lehtësi të ndryshme për vizitorët. Zhvillimet e reja duhet të përfshijnë një port të vogël si dhe atraksione bregdetare për vizitorët, lehtësi më të mira në zonën e plazhit, një qendër për vizitorët, dhe një hapësirë për argëtim, të mbështetur nga një numër më i madh restorantesh më të mira.
- Përshtatshmëria e zonave për zgjerimin e qytetit duhet të marrë në konsideratë rrezikun e tronditjeve sizmike dhe kushtet e tokës. Është përgatitur një Plan Konceptual Zonimi si bazë për zhvillimin e një masterplani të rishikuar për zhvillimin e ardhshëm të qytetit të Shëngjinit pasi ai që ishte në proces nuk i merr siç duhet parasysh ritmet e zhvillimit dhe mbrojtjen e mjedisit.

## 1.4. Zonimi sipas kategorive të tokës dhe rëndësisë

Fragmentizimi i tokave erdhi si rezultat i reformës për tokën, në zbatim të ligjit 7501 – "Për tokën ". Ndarja e tokës u bë sipas relievit fushor e kodrinor, sipas kategorisë e pjellorisë së ngastrave, sipërfaqeve nën e mbi ujë dhe largësisë nga qendrat e banuara etj. Kështu një familje fermere e ka tokën në 3-4 vende me nga 1-4 dynym. Një ndarje e tillë është negative sepse pengon sistemimin, kullimin, ujitjen, mekanizimin, zbatimin e teknologjive bashkëkohore etj. dhe si pasojë rendimentet janë të ulëta, kostoja e prodhimit e larte dhe të ardhurat e fermerëve janë të ulëta dhe efektiviteti ekonomik është tepër i vogël. Në këtë drejtim kërkohet që:

- të përfundojë plotësisht ndarja e tokës dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës që fermeri ta ndjejë veten pronar të ligjshëm;
- të punohet me komunitetin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, konflikteve dhe pengesave të hasura;
- të përfundojë regjistrimi fillestar i tokës në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe fermeri të pajiset me certifikatën perkatese, kjo do t'i hapë rrugë

tregut të tokës, dmth shitblerjes së saj dhe ngritjen e një tregu funksional për tokën.

Kategoria e tokës për qytetin dhe Malin e Rencit është e IVet, për Ishull Shëngjinin varion nga e IIItë, e IVet, e V në zonën e Kënallës, në Ishull Lezhë varion nga kategori e II – IV137t sipas parcelave ndërsa për Kune-Vain është kategori e IVët, por e nje rëndësie mjaft të madhe për turizmin.

Bujqësia është kontribuesi kryesor i ekonomisë së rajonit në studim. Rreth 60% e popullsisë jeton në zonën rurale dhe kanë bujqësinë si burimin kryesor i të ardhurave të tyre. Toka bujqësore, në të gjithë zonën, është shumë pjellore, me veçori të larta prodhuese. Por, me gjithë rëndësinë që ka në ekonominë e rajonit, sektori i bujqësisë mbetet akoma i pazhvilluar dhe shumë keq i menaxhuar edhe nga vetë fermerët.

*Tabela 4. Ndarja dhe përdorimi i tokës*

| Emërtimi | Sip. gjithsej në ha | Nga kjo | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Tokë bujq. në ha | Pyje në ha | Livadhe në ha | Kullota | |
| | | | | | Natyrore në ha | Artificiale në ha |
| Komuna Shëngjin | 2.579 | 1.425 | 624 | 51 | 479 | 0 |

Tokë bujqësore e ndarë është 1226 ha, me 0.12 ha për frymë dhe me koefiçient shfrytëzimi të tokës 47, tokë që nuk shfrytëzohet është 650 ha.

*Tabela 5. Ndarja e tokës bujqësore për komunë në zonën në studim*

| Komuna | Toka bujqësore në total (ha) | Pjesa e tokës bujqësore që shtrihet në fushë (ha) | Toka për përdorim bujqësor që gjendet në kodër dhe në mal (ha) |
|---|---|---|---|
| Shëngjin | 1.020 | 1.020 | 0 |

Megjithë pjellorinë e madhe të tokës dhe kushtet klimatike të shkëlqyera, zona përballet me probleme të mëdha nga përmbytjet, të cilat ndodhin rregullisht çdo vit. Si rezultat i tyre, prodhimi bujqësor është ulur ndjeshëm dhe është gjithmonë në rrezik. Gjithashtu, problematike paraqitet dhe "shplarja" e tokave gjatë përmbytjeve duke i bërë ato më pak pjellore. Këta faktorë kanë ulur dëshirën e fermerëve për të investuar në bujqësi.

Bazuar në rritjen e popullsisë është bërë një analizë e kërkesës për tokë bujqësore si në tabelën mëposhtë.

*Tabela 6. Kërkesa për toka (përllogaritje)*

| Zona | Rritja e popullsisë deri në 2020 | Kërkesa për tokë (Ha) |
|---|---|---|
| Komuna Shëngjin | 18.561 | 38,7 |

** Burimi: Projekti për Studimin e Zhvillimit Rajonal (EPTISA)*

Megjithatë deri ne 5% e kërkesës mund të plotësohet me rikuperimin e tokës së braktisur dhe me mbushjen e rregullt të tokave ndërmjet ndërtimeve të tanishme. Gjendja e tanishme është e pafavorshme për zhvillimin e bujqësisë, prandaj kërkohen që të krijohen grupime, shoqata apo ferma prodhimi private me madhësi sipërfaqe jo më të vogla se 10- 50 ha me qëllim që të rritet prodhimi nëpërmjet zbatimit të teknologjive të reja dhe të përballohet konkurenca e tregut.

# 2. Aktiviteti njerëzor dhe shërbimet

## 2.1. Punësimi, të ardhurat, biznesi

Ekzistenca e një sektori të mbizgjeruar informal, e bashkëshoqëruar nga punësimi informal si dhe vetëpunësimi në bujqësi sa për mbijetësë, e bëjnë të vështirë saktësinë e të dhënave mbi punësimin në rrethin Lezhë e aq më tepër në Komunën Shëngjin. Vetëpunësimi në bujqësi, sidomos në zonat rurale, ndikon në rritjen fiktive të punësimit, por që realisht nuk ndikon dukshëm në të ardhurat e këtyre familjeve. Rreth 48 % e njerëzve, që punojnë në bujqësi, janë të varfër dhe rreth 28 % e banorëve të zonave rurale bëjnë pjesë në shtresën e fundit për nivelin e të ardhurave.
Duhet theksuar se punësimi në Lezhë në sektorin shtetëror dhe privat jobujqësor është 10.96%, ndërsa për Komunën Shëngjin është 12.06 % nga ku vihet re tendencë në rënië e punësimit në sektorin shtetëror dhe rritje e lehtë e punësimit në sektorin privat jobujqësor.
Punësimi në sektorin bujqësor i zonave rurale nga zyrat e punësimit është marrë si i realizuar rreth 100%, por kjo është mjaft relative dhe sipas një studimi të kryer nga ana jonë punësimi në këto zona është rreth 51% e forcave aktive. Nuk ka evidenca të sakta në lidhje me të punësuarit në polici, ushtri apo administratën e burgjeve.

*Tabela 7. Punësimi sipas zyrës së punës Lezhë*

| Viti | Forcat aktive të punës gjithsej | Gjithsej | Sektori shtetror | Sektori privat jobujqësor |
|---|---|---|---|---|
| Komuna Shëngjin, dhjetor 2005 | 5.316 | 641 | 331 | 310 |







Punësimi më i madh ndodh gjatë sezonit të plazhit ,duke përfshirë edhe rreth 550 familje që gjatë kësaj periudhe strehojnë pushues. Lëvizja e popullsisë rurale drejt qendrave urbane ka rritur shkallën e papunësisë në mënyre të ndjeshme. Të ardhurat për frymë variojnë nga 165 Lekë deri ne 300 Lekë në ditë. Shkalla e papunësisë në nivelin 6.21% është vetëm për të papunë punëkërkues, rreth 5 herë më e lartë kjo

krahasuar me komunat e tjera të Lezhës. Por, duke llogaritur që 49 % e forcave aktive në bujqësi janë të papunë, në total rezulton që shkalla e papunësisë realisht është 40 %.

2.1.1 Bujqësia si burim i të ardhurave
Komuna Shengjin zotëron një fond toke prej 2579 ha toke bujqësore nga e cila vetëm 60% e saj është vene ne perdorim. Treguesit kryesor të prodhimit bujqësor (sip. e punuar dhe prodhim) kanë ardhur në rënie nga viti në vit. Pas vitit 1990 është ndjekur një politikë stimuluese e bujqësisë me kredi me interes të ulët, e cila u u ndërpre pas vitit 1997. Përmbyten nga reshjet, mosrihapja e kanalizimeve apo mosvënies në punë të hidrovoreve (për mungesë energjie apo amortizime të pjesëve mekanike), rritja e çmimeve të punimit dhe inputeve, pengon fermeret për mbjellje për pasojë rritet sipërfaqja e tokës djerrë.
Cilësia e ulët e tokës, mungesa e infrastruktures së ujitjes, ndarja e tokës në ngastra te vogla, largësia e madhe nga qendrat urbane dhe mundësia e paktë e daljes në treg (infrastruktura e dobët) janë faktorë të tjerë që ndikojnë negativisht në zhvillimin e bujqësisë në komunën Shëngjin.

Në drithëra, gruri zë vendin e parë për sipërfaqe të mbjellë. Perimet zënë një pjesë të konsiderueshme të sipërfaqes së mbjellë, sidomos në zonat rurale çdo njësi ekonomike familjare i kushton një sipërfaqe të caktuar perimeve, fasules, patateve. Bostani mbillet shumë në zonat fushore ku shërben edhe si burim të ardhurash për jetesë. Të mbjellat në tagji janë gjithnjë në rritje, ato sherbejnë si burim kryesor për ushqimin dimëror të blegtorisë dhë për kullotë.

Klima dhe pozicioni gjeografik i Komunes Shengjin favorizojnë rritjen e shumë llojeve të bimëve mjekësore si: sherebela, boronica, çaji i veriut, lisna, trumza, etj. Prodhimi i këtyre bimëve shërben si burim fitimi sezonal për të papunët në zonat përreth. Vlen të theksohet se kjo është e keqmenaxhuar dhe krijon probleme serioze për natyrën.

Për sa i përket drurëve frutorë, zona ka veçori edhe rritjen e ullirit dhe agrumeve. Pas një dëmtimi në vitin 1990, sipërfaqja e përdorur për vreshtari, ka ardhur në rritje jo vetëm prej traditës së hershme, por edhe leverdia ekonomike që kanë ato. Megjithatë, prodhimi aktual i verërave dhe pijeve del shumë pak në treg, pasi përdoret për konsum familjar, duke bërë që të mos shfrytëzohet plotësisht një burim i mundshëm të ardhurash.

Sektori i blegtorisë është mjaft i rëndësishëm për të ardhurat e banorëve. Pas vitit 1992 kemi një rritje të numrit të përgjithshëm të krerëve në bagëti të imta, gjedhë, shpendë e bletë. Shqetësues mbetet fakti i mbrojtjes profilaktike të tyre nga sëmundje të ndryshme. Rritja e tyre është kryesisht natyrale. Mishi dhe qumështi janë një burim i konsiderueshëm të ardhurash, por kjo vetëm për fshatrat në afërsi të qendrave urbane.

2.1.2 Peshkimi si burim të ardhurash
Është një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë dhe punësimit për banorët e Gjirit të Drinit e më gjerë. Në këtë sektor punojnë rreth 260 peshkatarë, të organizuar në shoqata, që peshkojnë në det dhe ujëra të brendshme (lagunat). Zënia e peshkut mundësohet nga një flotë peshkimi e përbërë nga 27 anije, ndërsa industria e përpunimit të peshkut në rajonin e Shëngjinit është përqendruar në dy kompani italo-shqiptare “Poseidon” dhe “Eurofish” dhe ajo shqiptare “Rozafa”. Dy kompanitë e para përpunojnë rreth 1000 ton peshk të kripur, lëndë e parë si produkt të ngrirë

në bllok ose i kripur në fuçi nga importi, kryesisht nga Spanja, Italia, Greqia, Maroku ose Argjentina. Produkti përfundimtar ka kryesisht destinacion vendet e BE-së.Ato kanë punësuar afro 500 punëtorë. Kohët e fundit është hapur edhe një kompani e re "Rozafa" e cila përpunon produkte të freskëta të detit Adriatik, kryesisht të zëna nga anijet e saj, produkt kryesisht për tregun e brendshëm dhe eksport.
Kushtet në të cilat punojnë këto kompani janë jashtë të gjitha standardeve të parashikuara nga legjislacioni në Shqipëri. Në to nuk aplikohen teknologji që janë miqësore me mjedisin, madje janë një nga burimet më të mëdha të ndotjes nga ujërat e zeza në zonën e Shëngjinit dhe më gjerë.

*Llojet e peshkimit në zonë*
Vitet e fundit me privatizimin e flotës së peshkimit dhe kërkesat e reja në tregun e peshkut, ka ndryshuar edhe struktura e zënies së peshkut. Deri në fund të viteve '90, për nevojat e ekonomisë së konservimit, ekzistonte praktika e zënies kryesisht pelagjike, rreth 75 % e peshkimit detar. Pas këtyre viteve dhe aktualisht kur industria e përpunimit është transformuar, edhe në bazë të rritjes së kërkesave të tregut vendas dhe eksport, për lloje të tjera peshku, aplikohet kryesisht metoda fundore. Por, nuk përjashtohen edhe metoda të tjera si ajo bregdetare, në laguna, gjuetia sportive dhe turistike.

Gjuetia fundore: Sot kjo metodë zë vetëm 9-12 % të volumit. Flota e peshkimit, e përbërë nga 27 anije, zë një sasi peshku rreth 600 ton në vit, duke zbatuar, kryesisht, metodën fundore në mbi 60 % të rasteve. Me këtë metode zënie, sigurohen lloje cilësore, me çmime të larta, që shkojnë në tregun vendas dhe për eksport.
Me këtë metode zënie, tregut i jepet për konsum peshk si: levrek, koce, qefuj, spalca, shojza etj. Kjo metodë peshkimi kërkon masa të rrepta kontrolli, për shkak se tërheqja e rrjetave në fund të detit nën thellësinë 20 m dëmton akuakuluturën e cila nuk është e klasifikuar për peshkim, duke prishur raportet dhe ekuilibrat e habitateve nëntokësore. Aktivizimi i kësaj gjuetie përbën një potencial të rëndësishëm të këtij sektori si dhe mundësi për një shfrytëzim më të mirë të tregut vendas me prodhime me çmime më të larta.

Gjuetia bregdetare: përdoret në Gjirin e Drinit me mrezhda, nica e grepa në thellësi 5 m, me rrjeta me dimensione 18 mm. Kjo praktikë shfrytëzohet kryesisht në kohën, kur peshku i drejtohet bregut e hyrjes për në lagunë në kërkim të ushqimit.
Kjo mënyrë gjuetie është shoqëruar edhe me pasoja si: dëmtim i bazës ushqimore dhe vezëve të peshqve që hidhen në bregdet, pengohet riprodhimi i peshkut, zënie peshku nën standarde, pengohet hyrja e peshkut në laguna.
Gjuetia në laguna: bëhet kryesisht me mjete tradicionale dhe dajlanë, të cilët janë të thjeshtë, të ndërtuar me tuba plastikë ose kallama. Ka rendiment të ulët nga 50 - 150 kg/ha dhe përbëhet kryesisht nga peshk cilësor si: levreku, ngjala, qefulli etj. Kjo gjueti bëhet duke shfrytëzuar ciklet biologjike të peshkut. Dajlanët hapen në prill dhe mbyllet në muajin gusht. Peshku qëndron në laguna, në kërkim të ushqimit, për një periudhë 5-6 mujore. Gjuetia në lagunë fillon nga muaji gusht e vijon deri në janar të vitit pasardhës. Gjuetia e pakontrolluar shoqërohet me pasoja si: dëmtimin e ushqimit bazë të peshkut, prishje të regjimit ujor dhe vendstrehimeve të peshkut, uljen e rendimentit të prodhimit për ha.

Gjuetia turistike dhe sportive: bëhet nga një numër i konsiderueshëm banorësh vendas ose të ardhur nga qytete zona të tjera, të cilët janë pjesë e gjuetisë së përditshme në grykën e Merxhanit, në bregdet dhe laguna. Në këtë lloj gjuetie sportive nuk përjashtohen disa gjuetarë amatorë, vendas të pajisur me liçencë të cilët e kanë si

mënyrë jetesë dukë zënë peshk cilësor, kryesisht levrek, për tregun vendas. Me këtë lloj gjuetie, mundësohet furnizimi i disa njësive shërbimi me peshk të freskët për konsum ditor.

*Prania e akuakulturës në zonë*
Privatizimi i sektorit të peshkimit si zënia, përpunimi dhe tregtimi i tij krijojnë mundësi për iniciativën e lirë në zbatimin e projekteve në akuakulturë. Këto projekte janë të lidhura me mundësitë reale natyrore që kanë banorët e Gjirit të Drinit, me traditën e tyre shumëvjeçare në këtë sektor.
Deri tani janë evidentuar dy projekte në akuakulturë, njëri është në proces zbatimi, ndërsa tjetri është në fazën e miratimit nga strukturat shtetërore kompetente.
Projekti, që është në zbatim, është i vendosur në mjediset ujore të territorit të portit. në një sipërfaqe prej 100 $m^2$, kultivon 3-5 ton midhje në vit, të cilat përdoren në tregun vendas.
Ndërsa projekti që është në fazën e miratimit parashikon një zonë prej 100 ha mjedis ujor, në të cilin do të montohen impiantet e kultivimit te midhjes me teknologji bashkëkohore, rendimente të larta dhe punësim të rreth 30 punonjësve.

## 2.2. Shërbimet

### 2.2.1. Sistemi i ujit të pijshëm dhe burimet e reja të ujit
Rrjedhjet ujore kryesore, që formojnë rrjetin hidrografik të Lezhës, janë: lumi Drin i Lezhës dhe lumi Gjadër (me sipërfaqe të pellgut 188 $km^2$, me lartësi deri 422 m mbi nivelin e detit, me prurje 8,00 $m^3$/sek.), si dhe përroi i Manatisë, në komunën Kolsh, Përroi i Vomës, në Kalivaç, komuna Ungrej). Ky pellg përfshin zonën Shëngjin-Zadrimë-Bregu i Matit dhe furnizon me ujë të pijshëm qytetin e Lezhës, Shëngjinit, si edhe të gjithë fshatrat e fushës. Sasia e ujit të shfrytëzuar prej tij, përfshi edhe ujin teknologjik, është 400 l/sek. Ujësjellësit kryesorë janë ai i Barbullojës dhe i Rrilës. Zona e ushqimit është kryesisht bregu i lumit Mat në jug. Rezervat ujore të llogaritura janë rreth 2500 l/sek. Në këtë fushë janë shpuar shumë puse, të cilët me vetërrjedhje japin prurje nga 10-60 l/sek. Por këto ujëra përdoren edhe për vaditjen e tokës bujqësore dhe për uljen e kripshmërisë, sidomos kur avullimi në laguna është shumë i madh. Pellgu përfshihet në depozitimet ujëmbledhëse zhavorrore me trashësi që rritet në drejtim të lumit Mat, deri në 180-200 m. Ato janë të mbuluar me një mbulesë argjilore dhe subargjilore me trashësi 45-50 m.

Ujërat nëntokësore janë të bollshme në qarkun e Lezhës dhe të shpërndara në pellgun e Lezhës. Ato janë të një cilësie të mirë, por në disa rajone ato njihen pak. Nga rezultatet e monitorimit duket se ujërat e këtij pellgu janë dy tipe, me fortësi të vogël e mineralizim të ulët (në Barbullojë) dhe ujëra me mineralizim të lartë. Nga analizat vërehet se ka rritje graduale të mineralizimit të përgjithshëm të natriumit (Na) dhe klorit (Cl). Në bazë të analizave të kryera për mikroelementë, këto ujëra rezultojnë pa përmbajtje të tyre. Problemet kryesore, që kanë dalë vitet e fundit, janë ato të rrezikut të depërtimit të ujërave të kripur, sidomos si rezultat i mbishfrytëzimit. Rreth 20% e ujërave nëntokësore përdoren për vaditje në bujqësi. Risku i ndotjes sipërfaqësore është i ulët falë mbulesës së trashë ekranizuese, largësisë së zonës së ushqimit dhe karakterit artezian të shtresave ujëmbajtëse. Ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësore përbën një domosdoshmëri për të siguruar furnizimin e popullatës me ujë që t'i përgjigjet kërkesave si nga pikëpamja sasiore ashtu dhe cilësore.

Furnizimi i një pjese të konsiderueshme të popullatës me ujë të pijshëm bëhet nga

gurra dhe burime. Kjo kryesisht në zonën veri-lindore të Lezhës. Lloji i furnizimit është me puse me ngritje mekanike dhe me rrjedhje të lirë. Kështu, rreth 60 % e njësive ekonomike familjare të Komunes Shengjin janë me ujë brenda në banesë, ndërsa 27,4 % janë me ujë jashtë banese dhe 12,6 % furnizohen me puse ose çisternë. Në rreth 15 % njësi ekonomike familjare mungon furnizimi me ujë, nga këto 90 % njësi ekonomike familjare janë në fshat. Në Komunën Shëngjin ka zona që furnizohen me 10 orë uje në ditë, por në periudhën e nxehtë të verës, uji është mjaft problem, sidomos per qytetin e Shëngjinit (2 orë në dite).

Në zonat urbane, numri i banesave me ujë brenda është 2 herë më i lartë se në zonat rurale. Numri i banesave me ujë jashtë në zonat rurale është 3 herë më i madh se në zonat urbane. Në Ishull Lezhë dhe Ishull Shëngjin më pak se gjysma e fshatrave kanë akses në shërbimin me uji të pijshëm (një pjesë e tyre me shpime të paligjshme në rrjet). Duhet theksuar se popullsia me akses në trajtimin e ujit të pijshëm përbën rreth 29,62 % të popullsisë në zona urbane dhe 20 % në zonë rurale, që mbulohet nga ujësjellësit urbanë apo ruralë, pra në total rreth 49.62 % e popullsisë. Pjesa tjetër e popullsisë furnizohet me burime natyrore apo shpime të vogla.

*Tabela 8. Treguesit kryesorë të ujësjellësave*

| | Lloji i burimit | Prurja (l/sek) | Tipi i Furnizimit | Koha e Furnizimit |
|---|---|---|---|---|
| Komuna Shëngjin | Depo | 100 | Rrjedhje e lirë | 2-10 orë |

<u>2.2.2. Sistemi i ujrave të zeza</u>

Trajtimi i organizmit të sistemit të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe i mbetjeve në territorin e Komunës Shëngjin është trajtuar për qytetin e Shëngjinit dhe zonës rurale

*Qyteti Shëngjin.*

Qyteti i Shëngjin ka një sistem ujrash të zeza të sistemuar (për pjesën e sipërme të tij, nga karburanti i Uldedajve deri tek Kampi i Punëtorëve) me kolektor rreth 2 km, projekt i financuar prej Bankës Botërore (2005). Ai plotëson nevojat e 50% të popullsisë së banorëve të qytetit të Shëngjinit. Për shkak të nivelit të ulët të qytetit, derdhja e ujrave të zeza kryhet nëpërmjet një stacioni pompimi nëntokësor në Knallë. Sasia e ujërave të zeza arrin në 380 $m^3$/ditë. Kjo zgjidhje mendohet të ketë ndikime negative ky për faunën dhe florën e kësaj zone.

Pjesa veriperndimore e qytetit derdh ujrat e zeza nëpërmjet nje kanali të mbyllur drejtpërsëdrejti në det (pranë portit), ndërsa pjesa sipër marinës bën derdhjen e ujrave të zeza në përroin që rrjedh në pjesën veriperëndimore të qytetit, sipër depove të karburantit dhe derdhet në det, në pjesën e portit. Ky përrua ka ujë vetëm në sezonin e vjështës dhe të dimrit, ndërsa pjesën tjeter të vitit ai krijon shumë probleme për banorët e kësaj zone nga era e keqe dhe derdhjet e ujrave të përpunimit të peshkut nga Kompania “Rozafa”. Në qytetin e Shëngjinit zhvillojnë aktivitet të fuqishëm prodhues 2 shoqëri përpunuese të peshkut,”Rozafa” dhe “Poseidon”, në të cilat janë të punësuar afro 120 punëtorë. Norma e derdhjes të mbetjeve teknologjike nga dy aktivitetet arrin në 1-1.5 l/sek. Aktiviteti prodhues “Eurofish” pavarësisht se aktivitetin e kryen në zonën e Bashkisë Lezhë shkarkimet e ujrave me mbetje teknollogjike i bën nëpërmjet kanaleve kullues që përshkojnë komunën Shëngjin përmes fshatit Ishull Shëngjin.

Ujërat e ndotura urbane shkarkojnë në ujërat sipërfaqësore 98% të NBO (Nevojës Biologjike për Oksigjen) dhe të gjithë ndotësve të tjerë, përveç vajrave dhe yndyrës,

që shkarkohen nga kompanitë e përpunimit të peshkut (20 $m^3$/ditë), ndonëse dy nga tre fabrikat e përpunimit kanë vendosur impiante për trajtimin e ujërave teknologjike. Përbërja e ujërave të zeza të Shëngjinit është tipike për shkarkime të këtij lloji, por ngarkesa organike dhe lëndët ushqyese janë në nivele më të ulëta se ato të vendeve të tjera evropiane:COD=160-164mg/l; BOD=66-67mg/l; TDS=0,375-0,8gr/l; SS=28-102mg/l; P-total=12,2-13,75mg/l; N-total=20,14-28,5 mg/l.

Duhet theksuar, se zona natyrore e liqenit të Knallës përbëhet nga një rrjedhje natyrore e ujërave karstike, që e kanë zanafillën nga maja e kodrës dhe përfundojnë në lagunë. Kjo është një sipërfaqe ujore kalimtare, e ndotur nga shkarkimet direkte të ujërave të zeza, që vijnë nga qyteti i Shëngjinit. Si rezultat i këtyre ndotjeve është i pranishëm edhe rreziku për jetën e organizmave detare, pasi preket direkt riprodhimi i llojeve.

Gjatë studimit, në afërsi të grykëderdhjes së Drinit janë hasur nivele të larta të lëndëve organike (proteina 61%, karbohidrate 34%, lipide 5%), deri në 3,5 herë më të larta se parametrat e matur në zonat ku nuk ka aktivitet njerëzor. Të larta janë gjetur edhe vlerat e pigmenteve aktive fotosintetike (0,94 mg/m), ndërsa biomasa bakteriale dhe densiteti i tyre në sedimente ishin brenda normave me vlera më të larta në afërsi të qyteteve, derdhjeve të lumenjve dhe në porte. Problem është edhe derdhja e pakontrolluar e mbetjeve të mjeteve të peshkimit në hyrje të portit Shëngjin.

Infrastruktura e sistemit të ujërave të zeza në zonat rurale mungon, 90% të rasteve grumbullimi bëhet në gropa septike apo në qendra të vogla, që derdhen në lumin Drin apo kanale të hapur. Në fshatrat I. Lezhë dhe I. Shëngjin, ujrat e zeza përfundojnë në kanale kullues dhe nëpërmjet tyre ose në Lumin Drin ose nëpërmjet hidrovorit të Tales dhe atij të I. Shëngjinit derdhen në det. Pjesa fushore mbetet më problematike, ku niveli i ujërave nëntokësore është i lartë, (sidomos pjesa afër kënetave) dhe sistemi i këtyre ujërave del në sipërfaqe pas ngopjes së tokës apo pas shirave të rënë.

Hartimi i një programi të vecantë pune nga ana e insektoriatit të mjedisit dhe atij të shëndetësisë për monitorimin e parametrave të ujit teknologjik të dala nga këto pika konservimi dhe vendosja e nyjeve të pastrimit të ujit teknologjik konsiderohen veprime urgjente.

<u>2.2.3. Mbetjet</u>

*Llojet e mbetjeve dhe mbetjet nga industria*

Mbetjet urbane gjenerohen nga burime shtëpiake, administrata shtetërore, sektori i ndërtimit, fabrikat e përpunimit të peshkut dhe birrës, shërbimet e ndryshme, porti, depozitat e naftës etj. Mbetjet e prodhuara grumbullohen pa asnjë ndarje paraprake, ndërsa bashkë me to grumbullohen edhe mbetje të tjera të rrezikshme (p.sh. bateritë, kimikate etj.). Komuna Shëngjin e ka të organizuar grumbullimin dhe transportin e tyre, nëpërmjet ndërmarrjes të shërbimit të Komunës. Zonat rurale, fshatrat I.Lezhë dhe I.Shëngjin ende nuk mbulohen me asnjë lloj shërbimi për grumbullimin apo transportin e mbetjeve. Zhvillimi i turizmit shton problematikën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në plazhe.

*Sistemet e grumbullimit te mbetjeve urbane*

Sasia e mbetjeve urbane për qytetin e Shëngjinit llogaritet në afërsisht 4200 ton/vit. Përbërësit më të rëndësishëm të mbeturinave janë: ushqimore (që zenë mbi 45%), letra, xhama, metale, tekstile, plastmas, gurë dhe dru. Mbetjet e ngurta urbane nuk administrohen mbi bazën e kritereve mjedisore. Deri më sot nuk ka asnjë vend depozitimi të mbetjeve urbane të ndërtuar mbi bazën e kritereve mjedisore.. Gjatë

muajve të verës, kur numri i banorëve të qytetit të Shëngjinit pesëfishohet nga turistët, mbetjet urbane të ngurta për Shëngjinin arrijnë 2 ton/ditë. Pika e hedhjes së mbetjeve është 9 km larg nga Shëngjini dhe është në kushte mjedisore dhe sanitare tepër të papërshtatshme. Një pjesë e mbetjeve urbane, përfshi ato inerte nga ndërtimet dhe prishjet, hidhen përgjatë lumit Drin ose në liqenin e Knallës.

Si rrjedhojë, rajoni po përballet me një situatë të pakëndshme për administrimin e mbetjeve jo vetëm në qytet, fshatra dhe rrugë, por edhe në fushat e hedhjes së tyre. Sasi të konsiderueshme mbetjesh urbane janë depozituar në pjesët anësore të rrugëve, duke mbushur kanalet kulluese jo vetëm me to, por, në disa raste, edhe me mbetje të rrezikshme.

Vetëdjegia e plehrave është dukuri e zakonshme për pothuajse të gjitha venddepozitimet e mbetjeve urbane, duke përbërë një burim potencial për lëndë helmuese tepër të rrezikshme, si dioksinat. Zjarret janë të qëllimshëm, në pjesën më të madhe për të lehtësuar procesin e marrjes së ambalazheve të aluminit, nga një numër banorësh që jetojnë me këtë aktivitet, ose për shkak të fenomenit të vetëdjegies nga mungesa e kryerjes së procesit të përpunimit të mbetjeve me mjetet e duhura. Hyrja në vendet e hedhjes së mbeturinave është e lirë si për njerëzit apo bagëtitë, duke rritur shkallën e ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj rrezikut për shëndetin. Në këto vende të hedhjes ka mungesa të theksuara për mjetet e nevojshme dhe fuqi punëtore, si edhe fonde të pamjaftueshme për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane apo dhe mosmenaxhim eficent i fondeve ekzistuese.

2.2.4. Përmbytjet

*Sistemi i mbrojtjes nga permbytjet*

Në gjithë territorin e Gjirit të Drinit krijohen ujra sipërfaqësore që krijojnë përmbytje të tokës bujqësore në nivele, siperfaqe dhe territore të ndryshme, sipas relievit. Për të shmangur përmbytjet në zonë, janë ngritur dhe funksionojnë disa masa mbrojtëse duke formuar një sistem mbrojtës:

1. Lumi Drin me dy argjinaturat e tij mbrojtëse me gjatësi 6,7 km në të cilën krijon një sipërfaqe ujore prej 18,4 ha.
2. Hidrovori Tale i cili krahas kullimit të zonës se Bregut tëMatës shërben edhe për kullimin e rreth 800 ha tokë bujqësore të fshatit I.Lezhë.
3. Hidrovori I.Shëngjin me kapacitet 4 m3/sek. I ndertuar i ri në vitin 2003.
4. Argjinatura K/11 dhe K/12 për mbrojtjen nga përmbytja e vërshimit të ujit të detit në raste baticash.
5. Një sistem kanalizimesh të përmasave të ndryshme si kanale të para, të dyta dhe të treta. Dy të parat janë në pronësi të ndërmarrjes së ujrave, e cila bën pastrimin dhe rikonstruksionin e tyre, ndërsa kanalet e treta janë në pronësi të fermerëve.

*Tabela 9. Të dhëna mbi rrjetin e kanalizimeve në komunën Shëngjin:*

| Lloji i kanalit | Kanale të para | Kanale të dyta | Kanale të treta |
|---|---|---|---|
| Gjatësia | 15,4 km. | 12,5 km. | 63,5 km. |

Zona më e rrezikuar është një sipërfaqe prej rreth 800 ha, ndodhur në lartësi rreth 1 m mbi nivelin e detit, e cila gjendet në afersi të dy lagunave Kunë-Vain.

*Shkaqet e përmbytjeve:*
Ndër faktorët që merren në konsideratë si shkak i përmbytjeve evidentojmë:

- Mos funksionimi me kapacitete të plota të H/V –ve Tale dhe I.Shëngjin. Kjo për mungesë të energjisë elektrike në sezonet me shtim të intensitetit të reshjeve. Mungesa e energjisë vjen nga defekti në linjat e furnizimit me energji ose nga mos vlerësimi i subjekteve që janë të ngarkuar, për vënjen e tyre në punë me kapacitete të plota.
- Thyerja e argjinaturës mbrojtëse të lumit Drin, në raste kur kapacitetet prurëse të lumit janë mbi mundësitë mbartëse të tij, për arsye të relievit të ulët të argjinaturës ose nga cilësia e dobët e punimeve mbrojtëse.
- Thyerja e argjinaturës mbrojtëse nga deti K/11 dhe K/12, të ndërtuara enkas për të përballuar detin e trazuar me baticë të lartë. Kjo dukuri e cila ndodh me rrallë është e kushtëzuar me masën e sigurisë së argjinaturës si nga lartësia dhe qëndrueshmëria e argjinaturës ndaj valës goditëse të detit.
- Mungesa e një strategjie të qartë mbi faktorët e përmbytjeve, rrugët e zgjidhjes, mungesa e donatorëve për zbatimin e projekteve afatshkurtër dhe afatmesëm.
- Mungesa e një bashkëpunimi ndërmjet subjekteve juridike (shtetërore), në vlerësimin e gjendjes dhe mbajtjen e përgjegjësisë për demet që shkaktonin përmbytjet.
- Mungesa e një legjislacioni që përcakton detyrimet ligjore ndërmjet palëve në procesin e përgatitjeve, për masat mbrojtëse ndaj përmbytjeve.
- Bllokimi i rrjetit kullues, vecanërisht kanalet e treta dhe veprat e tyre të artit si urat dhe tumbinat. Rrjeti prej 63,5 km kanale të treta në pronësi të fermerëve janë pothuajse jashtë funksionit dhe mbeten një rrezik përmbytjeje.
- Intensiteti i lartë i reshjeve në njësinë e kohës që i kalon mundësitë teknike të tërheqjes nga H / V –et dhe gjithë rrjeti i kanaleve kullues të të gjitha kategorive (I,II,III)[1)].

Shtimi i përmbytjeve ndodh ngaqë sistemi amortizues i reshjeve nuk ka funksionuar sic duhet dhe ndërhyrjet e mëdha kanë munguar në 10 vitet e fundit.
Disa nga shkaqet më kryesore të përmbytjeve në 15 vitet e fundit janë evidentuar në tabelën e mëposhtme:

*Tabela 10. Përmbytjet më të medha në 15 vitet e fundit:*

| Muaji | Viti | Sip./ha e përmbytur | Aresyeja e përmbytjes |
|---|---|---|---|
| Nëntor | 1992 | 840 | Thyerje e argjinaturës së lumit Mat dhe Drin |
| Gusht | 1995 | 700 | Mos funksionim i H/V I.Shëngjin |
| Shtator | 1996 | 800 | Reshje shumë të dendura shiu. |
| Tetor | 1996 | 700 | Reshje të dendura dhe mos funksionim H/V |
| Shkurt | 1998 | 500 | Thyerje të kanalit ujrave të larta |
| Dhjetor | 2000 | 300 | Thyrje të argjinaturës së detit në I.Shëngjin |
| Shkurt | 2002 | 400 | Thyrje të argjinaturës së detit. |
| Shtator | 2002 | 800 | Thyerje të argjinaturës lumit Drin |

1 Në periudha të ndryshme të vitit vecanërisht në fund të vjeshtës dhe fillim dimri intensiteti i reshjeve në njësinë e kohës ka qenë shumë i lartë, për rrjedhojë nuk është përballuar nga sistemi i kullimit dhe ka krijuar përmbytje

Ndër dëmet e shkaktura nga përmbytjet përmendim:

1. Përmbytjet kanë krijuar një dëm shumë të madh ekonomik gjithë komunitetit, duke nxjerrë.
2. Përmbytja e krijuar si rezultat i thyerjes së argjinaturës mbrojtëse nga deti ka krijuar ndryshime në parametrat kimik të tokës dhe rritjen e kripshmërisë së ujrave nëntokësore dhe sipërfaqeve të tokës bujqësore, me pasojë renjen e rendimentit në kulturat bujqësore.
3. Përmbytjet e vazhdueshme kanë krijuar ndjenjën e pasigurisë së komunitetit, ndaj sipërfaqe të shumta mbeten pa u mbjellur, me pretendimin se do të përmbyten.
4. Përmbytjet e shpeshta dhe qëndrimi i ujit për një kohë të gjatë mbi sipërfaqen e tokës ka patur pasoja të medha në strukturën fizike (kapilaritetin) të tokës dhe në prishjen e ekuilibrave natyrore.

## 2.3 Aktiviteti bujqësor

2.3.1 Analizë e përgjithshme

Kjo komunë, me popullsi prej 10555 banorë, ka në zotërim një sipërfaqe prej 1,2 dynym për banorë. Tokat e Komunës së Shëngjinit kanë pjellori natyrore të lartë se janë në përgjithësi aluvione të Drinit. Me gjithë problematikën që shoqëron bujqësinë, në këtë zonë është ruajtur një polikulturë e vetëseleksionuar nga viti në vit që i është përshtatur kushteve agro-klimatike.

*Tabela 11. Përdorimi i tokës në territorin e komunës*

| Tokë bujqësore | Tokë arë | Vreshtari | Tokë e papërdorur | Pyje | Livadhe Kullota |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.308 ha | 1.300 ha | 8 ha | 255 ha | 1720 ha | 210 ha |

Me gjithë përpjekjet që kanë bërë banorët, bazuar në traditën e mirë të zonës, bujqësia në komunë has probleme të mëdha me përmbytjet dhe mosfunksionimin e sistemeve tejet të nevojshme sic janë ujitja dhe drenazhimi. Këto sisteme janë dëmtuar dhe kanë pësuar deformime të mëdha si pasojë e keqpërdorimit të tokës, ndërtimeve pa kriter dhe mosmirëmbajtjes së këtyre rrjeteve.
Nxjerrja e produkteve në treg mbetet për t'u stimuluar. Burimet e kësaj zone do të shfrytëzoheshin më mirë po ndërtohej një tregu të madh bujqësor sidomos për periudhën e verës.

2.3.2 Prodhimtaria e tokës

Fragmentarizimi i parcelave ne peridhen pas 1990, krijoi pengesa serioze për kullimin e madh dhe të vogël. Kjo gjë ka çuar në pengimin e fermerëve për një shfrytëzim racional të sipërfaqeve të tokës që kanë në zotërim. Niveli i prodhimeve mbetet është i pranueshëm. Projekti që po zbatohet mbi Lumin Drin, krijon mundësi potenciale për kullimin e fushës nën kulturë, të mbi 255 ha tokë të braktisur apo lënë djerrë.

*Tabela 12: Struktura e mbjelljeve dhe rendimenti (kv/ha)*

| Kulturat bujqësore | Sipërfaqet e mbjella (ha) | Rendimenti (kv/ha) | Prodhimet e përgjithshme |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| Grurë | 60 | 35 | 2.100 |
| Misër | 59 | 50 | 2.950 |
| Perime | 139 | 215 | 29.885 |
| Fasule | 38 | 15 | 570 |
| Patate | 19 | 150 | 2.850 |
| Foragjere | 730 | 300 | 21.900 |

Siç dhe shihet nga tabela, kryesisht, kultivohen bimë që janë lënda bazë ushqyese për njerëzit (misër, grurë dhe perime) dhe për blegtorinë (foragjere). Vreshtaria mbetet spontane dhe për përdorim pothuajse familjar, me pak mundësi tregtimi në sasi të mëdha, për shkak të mungesës së tregjeve dhe kontratave me kompani përpunimi të pijeve alkoolike apo frutave.

Ndër faktorët, të cilët do të çonin në rritjen e prodhimtarisë mund të përmendim:

1. Krijimin e shoqatave për grumbullimin e prodhimeve e gjetjen e tregjeve;
2. Stimulimi nga shteti për mbrojtjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Gjetja e tregjeve mbetet ende një problem i pazgjidhur në nivel vendi, gjë e cila nuk stimulon dhe ata fermerë që përdorin me efiçencë pasurinë e tyre tokësore
3. Ngritja e fermave me cikël të mbyllur, ku mund të bëhen edhe përpunime artizanale për ekoturizëm.

2.3.3. Punësimi direkt në bujqësi.

Edhe pse me probleme si mungesa e tregut e vështirësi tw tjera, por dhe me faktorë nxitës e stimulues, si furnizimi me karburante pa akcizë, apo kultivarët e rinj, fermerët e kësaj zone e shohim bujqësinë sektopr të rëndësishëm vetëpunësimi.

*Tabela 13. Punësimi në bujqësi*

| Fshati | Nr. fermave | Fermerë të punësuar |
|---|---|---|
| Ishull – Shëngjini | 401 | 500 |
| Ishull – Lezha | 423 | 550 |
| Mali i Rrencit | 22 | 40 |

2.3.4. Sistemi drenazhues dhe kullues (për qëllime bujqësore)

Sistemi i drenazhimit në këtë komunë ka qenë shumë efiçent në vitet e kaluara, duke marrë parasysh lartësinë shumë të ulët nga niveli i detit dhe nevojën e lëvizjes së ujit me thithje nga ana e hidrovorëve. Sot me depozitimin e aluvioneve apo lëndëve inerte në kanalet kulluese dhe si rezultat i një mungese totale kontrolli të ndërtimeve të reja apo ndërhyrjeve të vetë fermerëve në sistem, ai ka dalë jashtë kontrolli dhe funksionon vetëm në segmente të caktuara.

Në Ishull Lezhë janë drenazhuar jo më pak se 70-80 ha, por goroneva e tyre nuk i kalon të 25 vitet. Hidrovorët, siç është ai i Tales, që tërheq ujërat e Ishull Lezhës, dhe hidrovori i Ishull Shëngjinit, që tërheq ujërat e këtij fshati, vazhdojnë të funksionojnë me gjithë ndërprerjet e herëpashershme për shkak të problemeve të energjisë.

Zona e Komunës Shëngjin kullohet nëpërmjet sistemit kullues të përbërë nga këto kanale:

a. Në Ishull-Lezhë – kanali i I$^{rë}$ - kullues, K-10-II = 4 km

- Kanale të II ta – kulluese, si K-12-II = 2,5 km gjatësi

K-13 _ II = 2,5 km, K- 14 – II = 1,5 km, K – 15 – II = 1,5 km K – 29 – II = 1 km gjatësi
- Kanale të III[ta] me një gjatësi = 25 km
Ndikim pozitiv ka edhe argjinatura që izolon kënetën e Vainit.

b. Në Ishull-Shëngjin- kanale të I[ra] – kulluese
K – 1 – II = 4,5 km gjatësi, K – 11 – II = 3,5 km gjatësi, K – 12 – II = 2 km gjatësi
- Kanale të II[ta] = 10 km gjatësi
- Kanale të III[ta] = 15 km gjatësi

Edhe ky fshat ka një argjinaturë paralel me lumin Drin me gjatësi prej 5 km , si dhe një argjinaturë paralel me liqenin e Merxhanit, me një gjatësi prej 7,5 km.
Projekti që po zbatohet mbi Lumin Drin, me objekt zgjerimin rreth 40 m nga Gjadri deri tek Ura e Lezhës dhe thellimin e tij me 60 m gjerësi nga Ura e Lezhës, ku fillon Komuna e Shëngjinit deri në derdhje në kufirin e skajshëm të kësaj komune, do të mundësojë një kullim më të mirë.dhe parandalohen përmbytjet në zonë. Nëpërmjet të këtij projekti do të sigurohen edhe 40 $m^3$ ujë/sek nga kaskada e Drinit dhe lumi do të rrisë prurjet e tij në drejtim të detit. Këto masa, do të sigurojnë shpejtësi në rrjedhje të Lumit Drin, prurje maksimale të inerteve duke rivendosur ekuilibra të reja në Lagunën e Vainit, frenim të përparimit të detit drejt tokës, kapacitete ujëmbledhëse (reshjet + prurje të përrenjve malorë) si dhe garantimin e habitateve me ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e faunës.

Për një sistem efiçent kullimi, kërkohet:
1. Pastrimi dhe thellimi i kanaleve
2. Ndërtimi i një strukture unike për kullimin
3. Lëvizja e drejtuar e mekanikës bujqësore
4. Formimi e funksionimi i shoqatës për ujitje.

2.3.5. Blegtoria

Komuna e Shëngjinit e ka ruajtur traditën e kultivimit (mbarështimit) të blegtorisë falë zonës ku shtrihet, sipërfaqes së mjaftueshme të tokës, bimësisë së shumëllojshme, duke përfshirë edhe Malin e Rrencit me mbi 52 ha tokë. Gjendja e mirë shëndetësore e gjësë së gjallë, kondicioni për mish, qumësht e vezë janë të kënaqshme dhe është bërë e mundur dhe mendimi i kualifikuar veteriner prej të paktën 30-35 vjetësh.
Edhe struktura e mbjelljeve në favor të blegtorisë është një argument më shumë në këtë drejtim. Fondi i tokës arë është 1300 ha, nga kjo 69,85 % është foragjere. prodhimet blegtorale plotësojnë nevojat, madje ka dhe rezerva për treg. Ndërtimi i dy baxhave do të ndihmonte në tregtimin më të mirë të prodhimeve blegtorale.

# 3. Burimet natyrore dhe zonat e mbrojtura

## 3.1 Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura të Komunës Shëngjin shtrihen në të dy anët e deltës së lumit Drin duke zënë një sipërfaqe prej 2300 ha (13 % të sipërfaqes së pyjeve të Lezhës ose 5 % të sipërfaqes së përgjithshme). Kune – Vaini është zona parë e mbrojtur e shpallur në vendin tonë në vitin 1940 dhe më pas është rishpallur me vendim qeverie dhe 4 herë (1940, 1960, 1977, 1983, 1992). Ai është një sistem ligatinor i përbërë nga një kompleks vlerash natyrore të papërsëritshme për larminë e habitateve dhe biodiversitetit, e vlerësuar prej kohësh si perlë e natyrës shqiptare. Ky kompleks ligatinor përbehet nga sistemet kryesore të habitateve detare, lagunore, kënetore si dhe sistemet joligatinore pyjet, shkurretat kullotat dhe toka bujqësore.

Mali i Rencit dhe lidhja me mjedisin bregdetar, ranor e shkëmbor, me fizionominë karstike të pjesës tjetër të terrenit, ka mundësuar një biodiversitetit të shumëllojshëm e specifik dhe pejsazhe tërheqese. Ndaj ai është propozuar të shpallet pejsazh i mbrojtur (kategoria V sipas IUCNsë).

3.1.1. Aspekti floristik

Më i studiuar nga pikëpamja floristike është Kune Vaini, nga ku bimët e larta rezultojnë të jenë 277 lloje të përfshira në 67 familje e 202 gjini. Familja me numrin më të madh të specieve është familja *Graminaceae* me 35 lloje, e ndjekur prej familjeve *Compositae* 24 lloje, *Leguminosae* 20 lloje, *Gyperaceae* me 16 lloje, Chenopodiacea 16 lloje, etj.

Në tipet kryesore të vegjetacionit në kompleksin lagunor Kune Vain (sipas A. Mullaj) janë:

1. Vegjetacioni ujor: përfaqësohet nga shoqërimi monifitik i *Zostera noltii* dhe *Ruppia cirrhosa* dhe me rol me pak të dukshëm shoqërimi *Lemna minor*.
2. Vegjetacioni hidro-higrofil: përfaqësohet nga shoqërimet me *Phragmites australis, Typha angustifolia, Scirpus sp.*
3. Vegjeatcioni halofil: përfaqësohet me shoqërimet me mbizotërim të llojeve të gjinisë *Arthrocnemum*; *Juncus*, të specieve *Scirpus holoschoenus, Saccharum ravennae, Plantago crassifolia, Schoenus nigricans* etj,
4. Vegjetacioni psamofil ose i dunave ranore që shtrihet deri në 10 km vijë bregdetare dhe 30 – 40m gjërësi. Fizionominë e këtij vegjetacioni e japin shoqërimet me llojet *Cakile maritima, Xanthium strumarium, Cyperus capitatus, Sporobolus pungens, Echinophora spinosa, Eryngium maritimum, Medicago marina* dhe më rrallë *Ammophila arenaria*.
5. Vegjetacioni pyjor përbëhët nga shoqërimet me specie mbizotëruese *Alnus glutinosae* dhe *Fraxinus angustifolia*, të llojit *Populus alba*, të llojeve të gjinisë *Pinus*.
6. Vegjetacioni shkurror zë një sipërfaqe të rëndësishme nga ku domonijnë shoqërimet me speciet Tamarix dhe Salix.

M. Rencit e i Shëngjinit përbëjnë një tërësi vlerash specifike natyrore si dhe të pejsazhit me kullotat e fragmentuara dhe shpatet me daljet sipërfaqësore të shkëmbejve gëlqeror. Karakteristike është pylli i rrallë me dushkun (*Quercus trojana*). Bimësia në këtë teren gelqeror dominohet nga ato tipiket për këtë si krifsha (*Phillyrea media* L.) dhe më rrallë dëllinja (*Juniperus sp.*), driza (*Paliurus aculeatus*), murrizi (Crategus monogyna) trëndafili i egër (*Rosa sp.*), ferra (*Rubus ulmifolius* Schott.). Gjithashtu ndeshen bimë

të tjera më të ulta si sherbela (*Salvia officinalis*), arrsi (*Teucrium polium*), bargjarpëri (*Teucrium chamaedrys* L.), lisra (*Thymus sp.*), trumza (*Satureja montana*), iqja (*Quercus ilex*),. Në ketë zonë rritet në gjendje natyrore dhe shega *Punica granata* që tashmë paraqitet si asociacion i rrezikuar në vendin tonë.

Bimësia barishtore është shumë e zhvilluar veçanërisht në stinën e pranverës me vlera të njohura për kullotjen e bagëtive si dhe mjaft bimë të tjera mjekësore. Në shpatin perëndimor bregdetar në mes të shkëmbijve gelqerorë si dhe në zonën e Knallës në anë të rrugës automobilistike në hyrje të Shëngjinit rritet mersina (*Myrtus communis*) bimë e njohur me vlera mjeksore e aromatike. Sherbela është një bimë tjetër karaktersitike e Malit të Rrencit me vlera spikatuara mjeksore .

Në sfondin lindor e verior të qytetit të Shëngjinit si dhe në atë bregdetar përtej Portit në drejtim të rërës së hedhur është kultivuar nga pisha e egër (*Pinus sp.*), e cila po dëmtohet nga nderhyrjet për ndertime e hapje trojesh të reja si dhe nga rënia e zjarreve.

<u>3.1.2. Aspekti faunistik</u>
Kune Vaini përben një thesar të vërtetë natyror me biodiversitet të pasur e pejsazhe mjaft tërheqëse. Lidhur me spektrin faunistik për llojet e njohura deri më sot sipas grupeve sistematike veçojmë (sipas F. Bego): molusqe 17 lloje, krustace 59, amfibë 10, peshq të kapur 12, reptilë 24, shpendë 196, gjitarë 23.
Llojet globalisht të rrezikuar si breshka e mesdheut *Caretta caretta*, dhe foka e mesdheut *Monachus monachus* kanë një pjesë të arealit të tyre në këtë zonë, ndërsa pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*) konsiderohet aksidental ose i zhdukur (i ndeshur deri në vitin 1993).

Gjitarët: Duke ju referuar rezultateve te monitorimit te Muzeut te Shkencave Natyrore Tiranë (2002) rezulton që llojet gjitarë bioindikatorë të rrezikuar (7 lloje) zënë 63.6% të llojeve bioindikatorë të vrojtuar (11 lloje). Kjo situatë është më negative krahasuar me zonat me të njëjtat tipare ligatinore të Nartës dhe Karavastasë. Ndër gjitarët të përkeqësuar ose janë në rrezik zhdukje e të rrallë që lidhen më mjedisin ligatinor, janë:

1. *Lutra lutra*, lunderza në gjirin e Drinit e laguna (i keqësuar)
2. *Delphinus delphi*, delfini vrojtuar në Shëngjin (i keqësuar)
3. *Meles meles*, baldosa, ultësirë bregdetare (në rrezik zhdukje)
4. *Tursiops truncatus* në gjirin e Drinit (i rrallë)

Shpendët: Ky kompleks ekologjik është më i rëndësishmi në vend për shpendët dimëronjës të ujit si dhe folenizimin e Ardeideve dhe Phalacrocorideve. Shpendët më të zakonshëm janë çafkat (Ardea cinerea, Egretta garzetta, Egretta alba), karabullakët (Phalacrocorax carbo etj) e mjellmat (Cygnus olor). Për shumëllojshmërinë e shpendëve studiuesit e kanë quajtur ketë ekosistem "Oaz të ornitologjisë së Mesdheut". Nga monitorimi i shpendëve të ujit dimërues dhe folezues në lagunat bregdetare shqiptare dhe riprodhim i shpendëve të ujit në lagunat e Kune Vainit rezulton të dhënat e mëposhtme:

*Tabela 10. Numri i shpendëve ujorë që vizitojnë lagunat e Kune - Vainit*

| Laguna | Nr. i shpendëve ujorë dimërues | Nr. individëve të shpendëve ujore dimërues | Nr. i shpendëve ujorë folezues |
|---|---|---|---|
| Kune- Vain | 32 | 2,318 | 12 |

Nga rezultatet e monitorimit vërehet një ulje e konsiderueshme e numrit të individëve dimërues. Kompleksi po humbet rëndësinë duke u varfëruar në mënyrë shumë drastike dhe shumë nga kapacitete mbartëse. Shpendët janë më shumë të përqëndruar në siperfaqet ujore të Vainit si dhe më pak në atë të Merxhanit, ndërsa në det numri i tyrë është mjaft i ulët.

*Tabela 11. Numri i individëve dimërues në vite në kompleksin e Kune- Vainit për disa vite në periudhën 1995-2002*

| Vitet | 1995 | 1996 | 1997 | 2001 | 2002 |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr individëve | 17.250 | 9.723 | 10.795 | 3.370 | 2.318 |

Nga vrojtimet e bëra në vitin 2006 vërëhet një përmirësim i situatës në lidhje me rritjen e numrit të individëve e llojeve si për shpendët dimërues ashtu edhe ato folenizues, por numri i tyre mbetet shumë më i ulët se kapacitetet mbartëse. Kështu folezuesit nuk kalojnë shifrën e 11 llojeve.

Zona është e njohur edhe për shpendët grabitqarë, ku veçojmë shqiponjën e malit (*Aquila chrysaetus*) dhe petritin (*Falco peregrinus*), lloje të rallë që mbrohen nga disa konventa ndërkombëtare. Nga shpendët të rrezikuar sipas librit të kuq[1)] janë 3 lloje të kërcënuar, 9 lloje të keqësuar, 1 lloj në rrezik zhdukjeje, 2 lloje të zhdukur, 11 lloje të rrallë.

Peshqit: Llojshmëri e konsiderueshme e peshqve që popullojnë ujrat e Drinit e ato të lagunës Kune Vai nga ku evidentojmë në Lumin Drin 12 lloje dhe në lagunat Kunë-Vain 11 lloje. Nga këta peshq të rrezikuar e që duhen të merren në mbrojtje janë: Lica (*Lichia amia*), Gofa (*Seriola dumerili*), Levreku (*Decentrarchus labrax*), Kavalli i lumit (*Lampetra fluvicatilis*), Amja (*Argyrosomus regius*), Tri pikaloshi (*Lebistes reticulatus*).

Amfibët dhe reptilët: Në zonën lagunore janë gjetur 10 lloje amfibësh e 29 lloje reptilësh. Zona e Kunes ka numrin më të madh të llojeve të rrezikuar të amfibëve e reptilëve (14 lloje). Numri i breshkave të tokës (*Testudo hermanni*) ka rënë rreth 2 herë në krahasim me 13 vite më parë; numri i shigjetës së gjatë (*Coluber caspius*), shigjetës së shkurtër (*Coluber gemonensis*), bollës së shtëpisë (*Elaphe longissima*), ka rënë rreth 4 herë. Rëniet e popullatave për shumë lloje reptilësh vihen re më shumë në pyllin e Kunës sesa në atë të Vainit. Mbetet shqetësuese zënia e breshkave të detit (*Caretta caretta*) në rrjetat e peshkimit. Këto kafshë globalisht të rrezikuara, fatkeqësisht, vriten nga peshkatarët. Popullatat e studiuara prej 104 individësh të breshkës së detit (*Caretta caretta*) i përkasin lagunës së Patokut dhe vetëm një ekzemplar i llojit (*Dermochelus coriacea*) është kapur në gusht të 2002, në afërsi të brigjeve të Kunës, në thellësi 3m. Zona ka vlera të veçanta për zvarranikët ku përmendim nepërkën me brirë (*Vipera amodytes*)

Insektet: Entomofauna dominohet nga llojet bregdetare, të ndërthuar pak a shumë me ato të pyjeve që rrethojnë këto zona dhe me entomofaunën e mjediseve me ujë

1 (Sipas Librit te Kuq botim i vitit 1997). Libri i Kuq përdor shkallën e rrezikimit të llojeve bimore e shtazore sipas percaktimeve te IUCN 1994 (Union Boteror për Ruajtjene e Natyrës) i cili kategorizon : Lloje /takson i zhdukur (Ex), ne rrezik zhdukje (E), i keqësuar (V), i rrallë (R), me status të papërcaktuar (I), nën shqyrtim (K*), i njohur në mënyrë tëpamjaftueshme (K), i shqetësuar (T), kanditat (C). sipas librit te Kuq)

të ëmbël apo me kripësi të papërfillshme. Në Kune Vain vërehen 117 lloje insektesh (11 lloje janë të kërcënuara) dhe 13 lloje insektesh ujore. Aktiviteti i llojeve dëmtonjës nuk paraqet rrezikshmëri të lartë, me përjashtim të Thaumetopoea pityocampa (proçesionaria e pishës) apo të Hypantria cunea, që duhet të mbahen në evidentim për shpërthimet masive periodike që japin.

Molusqet: Larmia e veçantë biogjeografike e këtyre mjediseve ligatinore nuk justifikon numrin e ulët të llojeve. Varfëria e saj lidhet me ndikimin e vazhdueshëm negativ mbi ekosistemet ligatinore.

*Tabela 12: Shpërndarja llojore e molusqeve në lagunat Kune Vain (viti 2002).*

| Laguna | Molusqe total në lagunë | Gastropodë në lagunë | Bivalvorë në lagunë | Molusqe total në bregdet |
|---|---|---|---|---|
| Kune | 40 | 16 | 24 | 23 |
| Vain | 30 | 13 | 17 | |

Numri i llojeve të kërcenuara është më i lartë (21 lloje) në krahasim me ligatinat e tjera të vendit tonë.

Varfërimi i biodiversitetit është i kërcënim i vazhdueshëm. Më e theksuar kjo rënie është në zonat e mbrojtura dhe ato bregdetare. Masat e marra për ruajtjen e llojeve të rralla dhe të kërcënuara të faunës e florës kanë qenë të pamjaftueshme. Vërehen mungesa të kapaciteteve në zbatimin e ligjit nga administruesit, ndërkohë që shqetësimi i organeve shtetërore dhe pushtetit vendor ka qenë i pakët. OJFtë nuk kanë rol aktiv në këto cështje.

Ndër shkaqet e varfërimit të popullatave dhe llojeve në kompleksin natyror Kune Vain veçojmë:

- Dëmtimi i habitateve, i pejsazhit, shqetësimet e ndryshme nga hyrja e lirë e njerëzve dhe automjeteve, ndërtimet dhe aktivitetet e bareve, moteleve, pikave të pushimit.
- Gjuetia intensive dhe pakriter e shpendëve brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura, përndjekja e kafshëve, kapja me qëllime tregtimi.
- Mungesa e kapaciteteve në ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në laguna konform normave teknike shkencore në favor të mbrojtjes së potencialit mbartës e prodhues natyror.
- Rritja e aktivitetit tregtues e përdorues për ushqim të molusqeve bregdetarë dhe detarë dhe gjuetia pa kriter e tyre.
- Peshkimi i vazhdueshëm me lëndë plasëse, gjuetia intesive në gryka e në bregdet, përdorimi i rrjetave fundore të peshkimit, peshkimi nga anijet në zona të ndaluara në bregdet.
- Dëmtimi i vezëve dhe të vegjëlve nga gjitarët grabitqarë, dhe shqetësimi me natyrë njerëzore
- Ndotja e ujërave për shkak të derdhjeve të ujërave të zeza të fshatrave përreth ujërave me përmbajtje detergjentësh, helmesh kimike bujqësore dhe karburantesh
- Mosfunksionimi i grykës së Matkeqes, erozioni bregdetar, kapërderdhja e detit po tjetërson herë pas herë vlerat natyrore të trashëguara e po ulen kapacitetet mbartëse të tyre
- Administrimi i zonës se mbrojtur pa plan menaxhimi

Ndonëse Mali i Rrencit përbën pjesën natyrore më të ruajtur të komunës Shëngjin, vlerat e kesaj zonë janë të pak të studjuara. Biodiversiteti dhe pejsazhi i tij janë në rrezik nga:

1. Tendenca e shtrirjes së zonës urbane në pjesën mbi port si dhe në drejtim të zonës bregdetare të njohur me emrin Rëra e Hedhur.
2. Presioni në rritje për ngulmime turistike në zonën e Rerës së Hedhur.

Për këtë arsye PLVM rekomandon:
i. Pezullimin në mënyrë të diferencuar i gjuetisë në zonat ligatinore bregdetare për një afat kohor prej 3-5 vjetësh, me qëllim që t'i jepet mundësi faunës së egër që të rimarrë veten dhe më pas të kalohet në një gjueti të kontrolluar dhe racionale brenda mundësive reale të vjeljes së gjahut;
ii. Hartimin e planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura;
iii. Rritjen e kontrollit nga Inspektoriatet e ndryshme mbi aktivitetet që ushtrohen brenda këtyre zonave, me qëllim rregullimin e tyre dhe minimizimin e ndikimit të tyre në faunë, si kullota, gjuetia, peshkimi, rigjenerimi;
iv. Ndalimin e peshkimit në ujërat e cekëta bregdetare, i cili paraqet pasoja të rënda edhe mbi gjitarët e ujit si delfinët të rënë në rrjetat e peshkimit në këto ujëra
v. Ndalimin e cdo lloj shqetësimi nga prania dhe veprimtaria e njeriut në zonat e njohura si zona të riprodhimit ose shtimit.
vi. Vendosjen e tabelave për mbrojtjen e shpendëve dhe parandalimin e shqetësimit;
vii. Rritjen e shkallës së edukimit mjedisor rreth rëndësisë ekoturistike të llojeve;
viii. Marrjen e masave dhe fushata ndërgjegjësuese për peshkatarët për rolin dhe rëndësinë e gjitarëve detarë për ekonominë dhe jetën detare.
ix. Ndalimin e peshkimit me lëndë plasëse;
x. Ndalimin e grumbullimit masiv të pakontrolluar të molusqeve në të gjitha mjediset, sidomos në periudhën e riprodhimit;
xi. Vendosjen e tabelave për mbrojtjen e shpendëve dhe parandalimin e shqetësimit;

### 3.2. Pyjet

Pyjet natyrorë të bregdetit të deltës së Drinit përfaqësohen nga pyje tipikë higrofilë, mbi toka aluvionale kryesisht bazike, me nivel të lartë të ujërave nëntokësore dhe të përmbytura shpesh nga vërshimet apo shirat e rrëmbyeshëm. Deri para 10-15 vjetësh, këto pyje përfaqësonin disa nga ekosistemet më të bukura të detit Adriatik, mjaft të larmishëm, gati të pakalueshëm nga ndërthurjet me lloje të ngjashme me lianat dhe me elementë higrofilë të përfaqësuar nga lloji indikator, verri i zi (*Alnus glutinosa*). Me vlera të barabarta të sasi-mbulesës është frashëri i ujit (*Fraxinus angustifolia*) dhe me pak janë lloje të tilla si rrenja (*Quercus robur*), plepi i bardhe (*Populus alba*), vidhi i vogël (*Ulmus minor*).

Dëmtimet në këto pyje 15-vjetët e fundit janë të dukshme në brezin Shëngjin-Kune. Pyjet e dikurshëm po marrin pamjen e shkurretave. Kthimi në gjendjen e mëparshme mund të kërkojë një periudhë më shumë se 10-15 vjeçare. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre pyjeve në zonën e Kunës degradon nga erozioni dhe kapërderdhja e ujrave të kripura detare. Një siperfaqe e konsiderueshme në zonën e Merxhanit (Kune) dhe Matkeqe (Vain) është e pyllzuar me pishë të egër (*Pinus halepensis, Pinus pinaster*) e cila është dëmtuar nga prerjet e kundërligjshme dhe erozioni. Pyllëzime të konsiderueshme me pishë janë berë në Malin e Rrencit, afër qytetit të Shëngjinit, mbi port dhe në zonën bregdetare në drejtim të Ranës së Hedhur. Edhe këto janë dëmtuar shumë nga prerjet e kundërligjëshme dhe zënia për troje ndertimi.

Nga problematika, që ka të bëjë me administrimin e fondit pyjor, vemë në dukje:

- Dëmtime e prerje disavjeçare të pyjeve kryesisht për materiale drusore. Tregtimi i paligjshëm i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera jodrusore;
- Zvogëlimi i sipërfaqes pyjore. Tre fidanishtet me një sipërfaqe totale 1.5 ha, nuk plotësojnë nevojat për fidanë pyjorë;
- Mungesa e kapaciteteve në zbatimin e ligjit nga administruesit.

Rekomandime

- Ruajtja dhe mbrojtja e këtyre formacioneve nga dëmtimet e mëtejshme.
- Ndërhyrja me ripyllëzime në zonat më të dëmtuara me lloje autoktone të tilla si verri i zi (*Alnus glutinosa*), frashërin e ujit (*Fraxinus angustifolia*) dhe veçanërisht me rrenja (*Quercus robur*), specie e rrezikuar për bregdetin shqiptar.
- Në zonat e dëmtuara, ku pylli ka marrë pamjen e një shkurrete të dendur, ndërhyrja me rrallime përbën domosdoshmëri për t'i dhënë hapësirë llojeve drunore.
- Ndërprerja e prerjeve të paligjshme dhe ndërtimeve në këtë brez pyjor për qëllime turizmi.
- Ndërprerja e prerjeve në ekonomitë pyjore të Malit të Rencit e ndërtimeve në to.

## 3.3. Dunat ranore

Sistemi i dunave ranore, në bregdetin e qarkut Lezhë, është i zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme veçanërisht në të dy anët e grykëderdhjes së lumit Drin. Në përgjithësi, ky sistem është i ruajtur mirë në kushtet natyrore. Por nga ana tjetër, aktiviteti njerëzor nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës për plazhe, urbanizimit dhe vendosjes se ngulmimeve turistike përbën një kërcënim të përhershëm dhe në rritje për ekosistemet e plazheve dhe dunave ranore të Kune Vainit.
Disiplinimi apo kufizimi i hapësirave të cilat shfrytezohen si plazhe; moslejimi i shtrirjes në të gjithë gjatësinë e ranishteve dhe dunave ranore të zonave që shfrytëzohen si plazhe turistike në Kune e Vain.
Përgatitja e planeve të veprimit për habitatet dhe speciet e rrezikuara për ranishtet dhe dunat ranore
Mbajtja nën kontroll dhe moslejimi i përhapjes së specieve invazive në këtë rajon

## 3.4. Menaxhimi i zonave te mbrojtura

Biodiversiteti është një nga trashëgimitë më të çmuara për komunën Shëngjin. Komuna Shëngjin ka në juridiksionin e saj kompleksin natyror Kune Vain, zona e parë e mbrojtur e shpallur në vendin tonë.

*Tabela 13. Te dhëna për zonën e mbrojtura të komunën Shëngjin*

| Emërtimi i zonave të mbrojtura | Kategoria menaxhuese | Siperfaqja ha | Shpallur në vitet |
|---|---|---|---|
| Kunë | Kategoria IV Rezervat Natyror i Menaxhuar | 800 | 1940,'60,'77,'83,'92 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Vain | KategoriaIV Rezervat Natyror i Menaxhuar | 1500 | 1940,'60,'77,'83,'92 |
| Mali i Rencit | Kategoria V Pejsazh i mbrojtur | 2000 | 2005 |
| Rëra e Hedhur | Kategroria III Monument natyre | | 2002 |
| Rivat e Drinit (Kune) | Kategroria III Monument natyre | | 2002 |
| Kënta e Kashtës (Kunë) | Kategroria III Monument natyre | | 2002 |
| Shpella e Sukës së Vogël (Mali i Rrencit) | Kategroria III Monument natyre | | 2002 |

*Zonat e propozuara*

| **Emertimi i zonës së propozuar** | **Kategoria Menaxhuese** | **Karaktersitikat** | **Komente** |
|---|---|---|---|
| Knalla | Rezervat Natyror i Menaxhuar (kategoria IV | Ndonëse në gjendje të dëmtuar, takohet një vegjetacion shkurror tipik mesdhetar, ndërsa në lagunën dhe ligatinat përreth saj takohen lloje të shumtë shpendë, për të cilat ajo ka fituar dhe statusin e një IBA. Laguna ka dhe vlera të veçanta për peshqit. | Është propozuar edhe në Strategjinë kombëtare të biodiversitetit e planin e veprimit 1999 |
| Zona bujqësore e ultësirës breg-detare të Kune Vainit | Pejsazh i mbrojtur (Kategoria e V) | Kultura të përziera të shumllojshme, florë e egër e larmishme periferike si dhe hapësira ligatinore me pamje tërheqëse | Është propozuar edhe nga projekti ELPA për Gjirin e Drinit 2006 |

Kategoria e IV menaxhuese (Rezervë natyrore e menaxhuar) sipas I.U.C.N.-së synon menaxhimin për ruajtjen (konservimin) përmes ndërhyrjeve menaxhuese.
Kategoria e VI menaxhuese (Rezervë e resurseve te menaxhuarar) synon mbajtjen e menaxhuar kryesisht për përdorim të qëndrueshëm të pasurive e ekosistemeve natyrore.
Sipas ligjit nr 8906 date 6.06.2002 "Per zonat e mbrojtura" këto zona duhet të funksionojnë me zonat bufer sipas përkatesisë së kategorisë menaxhuese për të zbutur ndikimetmbi to.

Ligji themelor për zonat e mbrojtura është ligji nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura" si dhe Vendimi i K M nr.267, datë 24.4.2003 "Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike"

Zonat e mbrojtuara të komunës Shëngjin vazhdojnë të administrohen pa një plan menaxhimi, dmth, pa objektiva menaxhuese dhe pa ndonjë menaxhim të mirefilltë. Si të tilla, është e vështirë që të monitorohet suksesi ose dështimi i praktikave menaxhuese në këto zona, dhe nuk mund të jepen rekomandime sa më specifike, të përshtatshme dhe në mbështetje të objektivave menaxhuese.

### 3.5. Bimët mjeksore e administrimi i tyre

Në zonat me vlera natyrore të Kune Vainit dhe e Malit të Rrencit gjendet një fond i pasur bimësh mjeksore, tanifere e eterovajore:

Mali i Rrencit prej vitesh është shfrytëzuar për mbledhjen e bimëve mjeksore nga ku veçojmë bimët më të grumbulluara:

*Tabela 14. Llojet e bimeve mjekësore që grumbullohen në zonë*

| Nr | Emri i bimës së mbledhur | Sipërfaqja ku gjendet (ha) | Prodhimtaria mesatare në një sezon (vjetor) ton e thatë |
|---|---|---|---|
| 1 | Sherbela | 160 | 35 |
| 2 | Trumza | 240 | 34 |
| 3 | Rigon | 8 | 0.1 |
| 4 | Mersina | 18 | 8 |

Problemi kryesor ka të bëjë me rënien e prodhimtarise së drogës bimore nga mbledhja pa kriter pa respektuar kushtet teknike nga komuniteti.

Kërkohen marrja e masave:

- Ndërgjegjësi i komunitetit për zbatimin e kritereve teknike të vjeljes
- Zbatimi i masave ligjorene raste të shkeljeve nga adminsitruesit
- Ndërmarrja e nismave të kultivimit të tyre për ruajtjen e fondit të këtyre bimëve
- Ruajtja e bimësisë mjeksore nga mbikullotja
- Hartimi e zbatimi i planeve të veprimit për llojet e rrezikuara.

### 3.5. Erozioni bregdetar

Erozioni detar është shumë i shprehur në bregdetin e zonës Kune - Vain Lezhë. Këtu deti përparon në drejtim të tokës mesatarisht 2.5 m çdo vit dhe nga viti 1936 ka arritur të spostohet deri në 400 m. Bazuar në burimet e literaturës dhe sipas specialisteve mësohet se këto zhvillime kanë të bëjnë me uljen e rrjedhjes së aluvioneve të lumit Drin 13 herë në krahasim me vitin 1854, kur ky lum u nda në dy degë. Kontribut serioz në ketë drejtim ka dhënë dhe sistemimi hidroteknik i rrjedhjes së Drinit (pas viteve 1963 nga ndërtimi i hidrocentraleve). Kjo dukuri sot është më e theksuar në anën e djathtë (në drejtim të rrjedhës) të grykëderdhjes së lumit Drin.
Nga kaperderdhja e detit e veçanërisht ajo e vitit 1999 (dhjetor) janë dëmtuar e tharë nga uji i kripur një numër i madh drurësh pyjor në zonën Kune -Vain

Nga evidentimet e ndryshme rezulton se dinamika e proçeseve hidrogjeomorfologjike mbetet shumë aktive në vijën kufizuese të sistemit lagunor Kune - Vain (pjesë e Gjirit të Drinit) me detin në favor të avncimit të detit në drejtim të tokës.

## 3.6. Çështje të pejsazhit

Për shkak të pozicionit gjeografik, hidrogjeologjik, klimës e mikroklimës, relievit, komuna e Shëngjinit ka një larmi të pejsazhit. Larmia e relievit, prania e të shumtë llojeve të habitateve ligatinore, lumore, detare, fushore e malore e ndërthurja e tyre bën që çdo vizitor të ndodhet përprara të parpiturave të këndshmë pejsazhiste. Shumë tërheqës dhe pikant janë pejsazhet e Malit gëlqeror të Rrencit, me hinka, puse e shpella karstike, me një vegjetacion pikant shkurretash e pyjesh të larmishme në lloje. Rëra e Hedhur si monument natyror afron jo vetëm vlera specifike, por të josh me pamjen që ndërthur ujin e rërën e pastër me vegjetacion e virgjër natyror e të shumëllojshëm.

Problemi kryesor mbetet të pejsazhi urban dhe portual, të cilët nuk kanë fizionominë me elementë të traditës apo të zhvillimit modern. Ai nuk ka një harmonizim me vlerat natyrore, por shpesh bie ndesh me to, siç është rasti i ndertimeve në zonën mbi portin e Shëngjinit.

## 3.7. Menaxhimi i ujrave dhe përmbytjet

3.8.1. Pasuria ujore

Territori i komunës Shëngjin shtrihet në një gjatësi bregdetare rreth 13 km dhe përshkohet nga lumi Drin në një gjatësi rreth 6,7 km. i cili kalon ndërmjet dy fshatrave I.Shëngjin dhe I.Lezhë. Në vijën bregdetare ka një sipërfaqe ranore prej 18 ha dhe sipërfaqe (ranore) të pyllëzuar prej 12 ha. Në dy anët e grykëderdhjes së Lumit Drin në formë brezi me gjatësi 10 km dhe gjerësi 1,8-5 km shtrihen dy Laguna (Ligatina) Kune - Vain te cilat kanë një sipërfaqe prëj 1860 ha, nga e cila 180 ha janë pyje, kullote 30 ha, sope kënetore 600 ha, ndërsa 1050 ha, janë sipërfaqe ujore. Ky territor shtrihet në një zonë ujembajtëse si nëntokësore dhe mbitokësore, përfshirë lumin, ligatinat dhe rezervuare natyrore.

Moszbatimi i legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar po krijon probleme jo të pakta në menaxhimin e ujrave në territorin e komunës. Shpesh burimet ujore janë kthyer në vendgrumbullime të ujrave të zeza dhe mbetjeve të tjera organike si derdhjen e ujrave të zeza të qytetit Shengjin në liqenin natyror të Knallës dhe ato të qytetit të Lezhës në lumin Drin.

*Ujrat nëntokësore:* Pellgu ujëmbajtës i Gjirit të Drinit është vijim i pellgut Barbulloje, të cilët kanë si ushqyes lumin e Matit. Rezervat ujore të llogarituar në këtë zonë janë rreth 2000 l/sek. Pellgu ujëmbajtës përfshihet në depozitimet ujëmbledhëse të zhavorëve me trashësi që rritet në drejtim të lumit Mat deri në 180-200 m. Në këtë zonë janë hapur dhe kanë funksionuar që nga viti 1975 rreth 30 puse artesiane me kapacitet nxjerres rreth 10-20 l/sek, të cilët kanë mundësuar shkripëzimin e ujit të lagunave. Nga monitorimi i këtij pellgu ujëmbajtësi rezulton ujë me fortësi të vogël e mineralizim të pakët. Ky tip vijon nga zona e Gjirit të Drinit në drejtim të Barbullojës. Sasi të konsiderueshme të këtij pellgu ujëmbajtës sot shfrytezohen si burim uji për banorët e zonës dhe qyteteve Lezhë e Shëngjin.

*Ujrat mbitokësore:*

- Deti Adriatik: Komuna Shëngjin ka një vijë bregdetare prej 13 km, e cila fillon në veri, në kufirin ndarës me komunën Velipojë dhe përfundon në jug me komunën Shënkoll.
- Lumi Drin: E përshkon komunën Shëngjin në një gjatësi rreth 6,7 km, me gjerësi në derdhje rreth 30 m, e cila vjen duke u zvogëluar në lartësinë drejt veriut në 25 ml. Në territorin e komunës lumi Drin zë një sipërfaqe ujore rreth 18,4 ha.
- Laguna (Kunë – Vain): Shtrihet në zonën jug-perëndimore të qytetit Shëngjin me sipërfaqe ujore prej 1050 ha, me thellësi mesatare 1,5 ml. (min 0,75 ml dhe max.5ml). Lagunat komunikojnë me detin me anë të dy kanaleve. Rezervati i Kunës fillimisht në vitet ‘70 ishte një ishull i vogël; rreth 1/3 e të cilit ishte i përbërë nga pellgje me ujë të ëmbël me reliev të valëzuar dhe një bimësi të larmishme.
- Knalla: Është një liqen natyror me ujë të embël, i ndodhur në afërsi të qytetit Shëngjin, ngjitur me rrugën kombëtare Lezhë - Shengjin. Ka një siperfaqe rreth 4483 m2, me thellësi maksimale nga 13 - 14 m. Ky mjedis ofron një habitat natyror të veçantë, për zogjtë që jetojnë në kallamishe (Rallidea) dhe lloje të amfibëve e zvarranikëve. Ky liqen ka pësuar ndotje të konsiderueshme për shkak të derdhjes në mënyrë të rregullt në të të një pjesë të ujrave të zeza të qytetit të Shëngjinit dhe mbetjeve të ndryshme nga e gjithë zona përrreth.

# 4. Turizmi dhe edukimi i komunitetit

## 4.1. Vlerësim i përgjithshëm

Ndryshimet e mëdha demografike në komunën e Shëngjinit, gjatë periudhës së tranzicionit, kanë shkaktuar zgjerimin e zonës së urbanizuar dhe cënimin e mjedisit në veçanti. Ndryshimet në qendrat urbane dhe sidomos në qytet po ndodhin me ritme të shpejta. Ndërtimi i objekteve pa leje që nuk i përgjigjen tendencave të sotme të zhvillimit urban si zonë turistike, ka sjellë dëmtimin e mjedisit dhe zvogëlimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytet.

Plazhi i Shëngjinit ndodhet 8 km nga qyteti i Lezhës, zona e plazhit është me gjatësi 6 km dhe me një sipërfaqe 30 ha, nga e cila 18 ha sipërfaqe rërë e 12 ha sipërfaqe e gjelbër. Plazhi i Shëngjinit vizitohet nga 40 – 50 mijë pushues në ditë të veçanta të javës gjatë periudhës (korrik – gusht) nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia, por edhe nga turistë të vendeve perëndimore. Kjo përbën një burim të madh të të ardhurave për Komunën Shëngjin, por në të njëjtën kohë përbën edhe një burim zhvillimi. Me rritjen e kapaciteteve akomoduese të turizmit, çdo vit, është rritur fuqia punëtore: aktualisht për vitin 2006, ka patur 140 punëtorë të përkohshëm dhe 60 të përhershëm.

Zona ka një numër të konsiderueshëm vendesh akomodimi në hotele, motele dhe shtëpi private. Hotelet dhe motelet gjenden kryesisht në qytetin e Shëngjinit dhe në hyrje të lagunës së Kunës. Tabela 2 tregon gjendjen aktuale, kapacitetet e akomodimit dhe perspektivën e zhvillimit.

*Tabela 15: Bilanci i akomodimit për turistët dhe parashikimi për të ardhmen*

| Emërtim | Gjendja 2006 | Afat mesëm | Afatgjatë |
|---|---|---|---|
| I. hotele + motele | 12 | 17 | 40 |
| Dhoma akomodimi | 330 | 500 | 1.400 |
| Nr. mesatar i dhomave hotel+motele | 27 | 30 | 35 |
| Nr. i shtretërve | 450 | 850 | 2.350 |
| Nr. i pushuesve për fjetje | 700 | 1.100 | 2.900 |
| II. Dhoma në shtëpi private | 300 | 500 | 900 |
| Nr. i shtretërve | 430 | 750 | 1.000 |
| Nr. i pushuesve për fjetje | 600 | 1.050 | 2.000 |
| Totali (I+II) | 630 | 1.000 | 2.300 |

Dhomat frekuentohen në kulmin e sezonit të verës, por këto kapacitete janë pothuajse të pashfrytëzuara nga pushuesit për afro 10 muaj të tjerë të vitit.

Koncepti i përmirësimit të turizmit duhet të bazohet në përmirësimin e destinacionit ekzistues, duke kërkuar zhvillimin edhe të turizmit ekologjik dhe turizmin e interesit të veçantë. Mundësitë e zhvillimit të ekoturizmit janë të mëdha për komunitetin, ku kemi dy rezervate natyrore Kune-Vain të përcaktuara dhe të administruara.

Qëllimi është që kjo zonë e mbrojtur natyrore të shfrytëzohet për pushime në natyrë.

Nxitje duhet të jetë turizmi i interesit të veçantë p.sh. gjuetia e shpendit të egër , vrojtimi i shpendëve shtegtarë.

Pozicioni gjeografik i shtrirjes së komunës ofron larmi relievi: ndërthurje të malit me

fusha dhe vijë bregdetare, duke krijuar mundësi që dhe zona e Malit të Rrencit të përcaktohet si peisazh i mbrojtur. Rezervatet e Kune – Vainit dhe peisazhi i Malit të Rrencit përbëjnë një zonë me rëndësi të veçantë, për sa i përket natyrës tërheqëse dhe potencialit pë sigurimin e të ardhurave. Këto zona, me një menaxhim të mirë, mund të ofrojnë një zhvillim të shpejtë ekoturizmit.
Strategjia e zonës synon në mosdëmtimin e vlerave natyrore dhe ndërhyrjet do të jenë të përcaktuara duke mos shkaktuar mbishfrytëzimin e burimeve natyrore. Ky plan duhet të përfshijë politika dhe veprime konkrete që do të mundësojnë hyrjen e vizitorëve dhe të sigurojnë lehtësira apo shërbime për pushuesit në natyrë. Strategjia e shtrirjes së investimeve në turizëm duhet të përqendrohet në qytetin e Shëngjinit, duke krijuar një qendër të rëndësishme turistike.
Qendrat e caktuara duhet të kenë një informacion sa më të plotë për vizitorët (broshura, fletë palosje, harta e qytetit, etj). Organizatat e turizmit do të japin informacion më të plotë mbi organizimin e aktiviteteve, shkëmbimet e përvojave, promovime në interes të turizmit, faqe interneti për tërheqjen e turistëve.

Në territorin e komunës ushtrojnë aktivitet 3 OJF: ajo e turizmit, e peshkimit dhe e gjuetisë së shpendëve të egër. Këto shoqata janë të përfshira në zhvillimin e ekoturizmit dhe ofrojnë shitjen e prodhimit.

Në komunën Shëngjin kemi tre shkolla 9-vjeçare, 1 shkollë të mesme të përgjithshme. Në shkollat 9-vjeçare shkojnë 100% e fëmijëve që kanë moshën e duhur, në shkollën e mesme 82 % e atyre që përfundojnë shkollën 9-vjeçare, ndërsa të diplomuar në universitete janë afro 7,5 % e popullsisë. Për t'i ardhur në ndihmë zhvillimit të turizmit, është hapur, në qytetin e Lezhës, shkolla e mesme profesionale ekonomi –turizëm, që çdo vit ndiqet nga mbi 20 nxënës nga komuna.
Sistemi i edukimit ka qenë në nivele jo të dëshiruara për zhvillimin e turizmit, ndërgjegjësimin e komunitetit për avantazhet e mëdha që sjell kjo fushë.

# 5. Lista e problemeve



| Problemi | Shkaku | Ndikimi | Popullsia që preket | Shkalla e ndikimit | Prioritarizmi1 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Mungesa e masterplaneve të zhvillimit urban | - Mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore | - Mungesë infrastrukture<br>- Prishje e sip. të gjelbërta dhe e tokës bujqësore<br>- Zhvillimi i bujqësisë dhe i turizmit, i paqëndrueshëm | 10552 banorë | E lartë | * * * |
| 2. Mungesa e një stabiliteti në administrimin urban | - Mungon dixhitalizimi i gjendjes ekzistuese<br>- Mungesa e masterplaneve të zhvillimit | - Rënie e cilësisë së shërbimeve publike<br>- Zvogëlimi i të ardhurave nga turizmi | 10552 banorë | E lartë | * * * |
| 3. Mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësore | - Mungesa e planeve menaxhues të administrimit të ujërave | - Pakësimi i rezervave ujore | 10552 banorë | E mesme | * * * |
| 4. Mungesë infrastrukture për ujin e pijshëm | - Mungesë e burimeve financiare<br>- Keqmenaxhim administrativ | - Rënie e aksesit në këtë shërbim, për banorët<br>- Zhvillim i paqëndrueshëm i turizmit<br>- Mundësi e ndotjes së ujit | 20912 banorë | E lartë | * * * |
| 5. Rritje e shtuar e trysnisë njerëzore mbi mjedisin fizik, nga imigrimi i brendshëm në drejtimin fshat – qytet, sidomos drejt zonave fushore | - Politika jo të qarta zhvillimi për zonat rurale<br>- Mungesë infrastrukture në shërbimet bazë | - Largimi i popullsisë<br>- Nivel i ulët i shërbimeve bazë<br>- Zënie e tokës bujqësore | 20912 banorë | E lartë | * * * |
| 6. Mungesa e kushteve të përshtatshme të punës dhe e hapjes së vendeve të reja të punës | - Mungesë e kreditimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme<br>- Kuadër ligjor jo i plotë | - Rënie e të ardhurave për frymë<br>- Rritje e sëmundjeve infektive dhe respiratore | 5316 banorë | E lartë | * * * |
| 7. Mungesa e burimeve financiare dhe keqmenaxhimi i të ardhurave | - Mungesë koordinimi me donatorët<br>- Mungesë përgjegjësie në administrim | - Ulje e mirëqenies<br>- Zhvillim i paqëndrueshëm i turizmit | 20912 banorë | E lartë | * * * |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 8. Mospunësimi me përparësi i banorëve të komunës nga ndërmarrjet me aktivitet brenda territorit të komunës | - Mungesë koordinimi<br>- Mungesë kualifikimi<br>- Mënyrë presioni për banorët vendas | - Nivel i ulët jetese<br>- Rënie e të ardhurave për frymë | 5316 banorë | E lartë | * * * |
| 9. Mungesa e mjeteve financiare nga burime të brendshme për investime me karakter mjedisor, në fushat prioritare | - Mosdhënie e kredive me interesa të ulëta<br>- Akordimi i fondeve jo të mjaftueshme nga institucionet qendrore<br>- Mosmenaxhim i mirë i fondeve | - Zhvillim i paqëndrueshëm i turizmit<br>- Një administrim i paqëndrueshëm i mjedisit<br>- Rritje e potencialit ndotës | 30912 banorë | E lartë | * * * |
| 10. Ulje e cilësisë së përbërësve të tokës | - Përmbytjet, kimikatet etj. | - Ulje e rendimenteve<br>- Ulje e të ardhurave | 10552 banorë | E lartë | * * * |
| 11. Humbja e ujit gjatë procesit të shpërndarjes dhe rënia e cilësisë së tij | - Lidhjet e paligjshme<br>- Mungesa e matësve<br>- Infrastrukturë e shpërndarjes e amortizuar<br>- Ndotje e ujit të pijshëm<br>- Mungesë e kontrolleve sanitare | - Ulje e mirëqenies<br>- Pakësim i rezervave ujore<br>- Rritje e të sëmurëve nga përdorimi i ujit të ndotur | 20912 banorë | E mesme | * * * |
| 12. Ndërgjegjësimi i banorëve lidhur me mirëpërdorimin e ujit | - Ndërhyrje të pasigurta në rrjetin e ujit të pijshëm<br>- Ndërtime të paligjshme brenda zonave të mbrojtura | - Mosadministrim i mirë i ujit<br>- Rritje e sëmundjeve infektive<br>- Zhvillim i paqëndrueshëm i turizmit | 10552 banorë | E lartë | * * * |
| 13. Kuadër i mangët ligjor e rregullator dhe mangësi në zbatimin e atij ekzistues, nga subjektet publike dhe private | - Efektshmëri e ulët në zbatimin e ligjit<br>- Mungesë e koordinimit ndërdikasterial | - Mosadministrim i mirë i ujit<br>- Rritje e sëmundjeve infektive<br>- Keqpërdorim i rezervave ujore | 10552 banorë | E lartë | * * * |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 13. Mbetjet urbane grumbullohen në vende të hapura të pakontrolluara, të papërpunuara dhe pranë qendrave të banuara | - Rritja e dendësisë së popullsisë, sidomos pranë zonës bregdetare<br>- Rritje e konsumit<br>- Mungesa e planeve të përgjithshme për përcaktimin e vendeve<br>- Probleme të pronësisë mbi tokën<br>- Mungesë përvoje në menaxhimin e mbetjeve urbane dhe përgjegjësi ulët e komunitetit<br>- Kapacitete dhe fonde jo të mjaftueshme dhe të përshtatshme | - Në shëndetin e komuniteti, duke rritur mundësinë e shtimit të infeksioneve, si rezultat i dekompozimit të mbetjeve urbane në pika të hapura, ose/edhe spontane<br>- Në ndotjen e mjedisit, me rrjedhojë ndotjen e ajrit, të ujit etj.<br>- Ndikim negativ në ekosisteme,<br>- Ndikim negativ në ekonomi dhe zonat turistike, menaxhimi i keq i ndotjeve urbane largon turistët | 10552 banorë + pushuesit e shumtë | E lartë | * * * |
| 14. Ndotje të shkaktuara si rezultat i dëmtimit ose i mungesës së kanalizimeve të ujërave të zeza | - Dëmtim i sistemit ekzistues të ujërave të zeza<br>- Mungesë totale e rrjetit të kanaleve të ujërave të zeza, pothuajse në të gjitha komunat<br>- Mungesë e fondeve për studime dhe ndërtime të këtyre rrjeteve<br>- Mungesë e planeve urbane, për të tilla sisteme | - Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave që përdoren për t'u pirë<br>- Rrit rrezikun për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, infektive<br>- Ndotje e mjedisit<br>- Ndotje e ujërave nëntokësore<br>- Ndikim negativ në faunë<br>- Prishje peisazhi natyror dhe ndikim negativ në turizëm | 10552 banorë + pushuesit e shumtë | E lartë | * * * |
| 15. Mbetjet teknologjike të përpunimit të peshkut | - Rritja e aftësisë përpunuese e pikave të përpunimit<br>- Mosfunksionimi i impianteve për përpunimin e ujit teknologjik<br>- Mungesa e një studimi për pikën e shkarkimit të tyre | - Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave të detit<br>- Ndikim negativ në faunën e detit<br>- Rritet rreziku i infektimit të pushuesve dhe turistëve në plazh | Shumë pushues | E Lartë | * * * |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 16. Degradimi i zonës së mbrojtur Kune-Vain, varfërimi i biodiversitetit, rritja e presionit ndaj saj | - Gjuetia e kundërligjshme<br>- Mungesa e kapaciteteve të organeve përgjegjëse në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e faunës dhe administrimin e fondit të gjuetisë<br>- Mungesa e investimeve në mbajtjen hapur të grykës së Matkeqës<br>- Ndërtimet në brendësi të zonave të mbrojtura, zhvillimi kaotik urban<br>- Mungesa e ndërgjegjësimit të komunitetit për mbrojtjen e pasurive faunistike dhe floristike | - Rënia e theksuar e llojeve të shpendëve dhe e llojeve të tjera, veçanërisht në zonën e mbrojtur Kune-Vain<br>- Pakësimi i popullatave të shpendëve dhe gjitarëve<br>- Dëmtimi i habitateve, fragmentarizmi dhe dëmtimi i korridoreve ekologjikë<br>- Dëmtimi i pejsazhit në Kune-Vain dhe në shpatet malore, nga prerjet e kundërligjshme | Popullsia e komunës Shëngjin, si dhe të qytetit Lezhë. Indirekt preket dhe gjithë popullsia e rajonit e më gjerë, nga dëmtimi i potencialeve ekoturistike | E lartë<br>(ka rënie më shumë se 50 herë e numrit të çifteve të shpendëve folenizues, në krahasim me vitin 1951 të kolonisë së Kunes. Habitatet janë dëmtuar rëndë nga prerjet e drurëve) | *** |
| 17. Dëmtimi dhe rritja e rrezikut të tjetërsimit të terrenit dhe i varfërimit të biodiversitetit të zonës së Knallës | - Ndërtimet urbane në afërsi dhe tendenca për mbushjen e sistemit ligatinor për troje | - Dëmtimi i habitateve<br>- Varfërimi i biodiversitetit | Popullsia Shëngjin dhe ajo e Ishullit Shëngjin | E mesme | *** |
| 18. Dëmtimi i formacioneve dhe i drurëve pyjorë, përkeqësimi i habitateve të Kune-Vainit, si dhe i pishës në shpatin bregdetar në drejtim të Rërës së Hedhur | - Prerjet pa kriter e të paligjshme disavjeçare në pyjet e Kune-Vainit dhe Malit të Rrencit<br>- Kullotja pa kriter dhe intensive, veçanërisht në shpatet në afërsi të zonës urbane të Shëngjinit dhe të Ishull Shëngjinit<br>- Zhvillimi kaotik urban, zënia e tokës nga ndërtimet në ekonomitë pyjore, pa kriter e pa studime, veçanërisht mbi Port | - Dëmtimi i vegjetacionit drunor e shkurror, në zonën në studim<br>- Varfërimi i vegjetacionit, veçanërisht në afërsi të zonave urbane dhe asaj në studim, në përgjithësi.<br>- Dëmtimi  nga ndërtimet i pyllit me pishë të mbjellë, në malin e Shëngjinit etj. | Popullsia e qytetit Shëngjin dhe e fshatrave Ishull Shëngjin, I.Lezhë dhe malit të Rrencit | E lartë | *** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 19. Dëmtimi dhe ulja e prodhimit të bimëve mjekësore, tanifere e eterovajore, nën kapacitetin mbartës natyror | - Mbledhja pa kriter dhe pa zbatuar kushtet teknike<br>- Mbikullotja në zonën me mersine e bimë të tjera mjekësore, tanifere e eterovajore | - Varfërimi dhe ulja e prodhimit të sherebelës, trumzës, lisrës, mersinës etj. | Popullsia e Malit të Rrencit, Ishull Shëngjit dhe 5% e qytetit të Shëngjinit | E lartë | ** |
| 20. Kapacitete të ulta menaxhuese dhe administrim i papërshtatshëm i zonave të mbrojtura | - Mungesa e studimeve dhe e mbështetjes financiare për bërjen e planeve të menaxhimit<br>- Mungesa e një autoriteti të përshtatshëm e të aftë për zbatimin e ligjit | - Mbishfrytëzimi i potencialeve prodhuese, të cilat kanë rënë shumë mbi kapacitetet mbartëse<br>- Ulja e përfitimit ekonomik të komunitetit, si dhe e mbrojtjes së zonës | Popullsia e fshatrave Ishull Lezhë dhe Ishull Shëngjin | E lartë | *** |
| 21. Erozioni bregdetar | - Pakësimi disavjeçar i prurjeve inerte të lumit Drin nga ndërtimi i hidrocentraleve në kaskadën e tij, si dhe devijimi i prurjeve në lumin e Bunës<br>- Mungesa e studimeve dhe e investimeve për ndalimin e erozionit | - Humbet mesatarisht 2.5m tokë në vit me formacion pyjor, në një gjatësi 3-4 km vijë bregdetare në Kune-Vain, nga erozioni bregdetar | Fshatrat Ishull Lezhë dhe Ishull Shëngjin, qyteti i Shëngjinit | E lartë | *** |
| 22. Dëmtimi i sistemit kullues | - Mosvlerësim nga subjektet e interesuara<br>- Mungesë fondesh | - Përmbytje sipërfaqësore me pasoja dëmtimin e kulturave bujqësore dhe të zonave të mbrojtura | Rreth 4500 banorë ose 45% e popullsisë së komunës | E lartë | * * * |
| 23. Kapacitete të ulta kullimi | - Mungesa e hidrovoreve<br>- Mospërballim nga sistemi aktual i kullimit | - Qëndrim për disa ditë me sipërfaqe të përmbytura<br>- Ulje e cilësisë së tokës<br>- Shpëlarje e sipërfaqes<br>- Dëmtim i habitateve të mundshme të florës dhe të faunës | 3000 banorë | E lartë | * * * |
| 24. Bllokime të vazhdueshme të sistemit kullues | - Mbyllja e kanaleve të treta. | - Dëmtim i prodhimit dhe ulje e rendimentit | 5500 banorë | E lartë | * * * |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 25. Mosfunksionimi i një sistemi unik për kullimin | - Parcelizimi i tokës bujqësore | - Rënie të prodhimit<br>- Rrezik i madh përmbytjesh të vazhdueshme<br>- Braktisja e tokës bujqësore | 4000 banorë | E mesme | * * |
| 26. Dëmtim i pjesshëm i kanaleve të dyta | - Zënia nga inertet dhe bllokime nga banore | - Mosfunksionimi i sistemit kullues | 3500 banorë | E mesme | * * |
| 27. Dëmtim i plotë i kanaleve të treta | - Mosvlerësimi nga fermerët si pronarë të tyre | - Zgjatje pa fund e përmbytjeve | 6600 banorë | E lartë | * * * |
| 28. Mungesa e sigurisë së argjinaturës së lumit Drin | - Mungesa e një investimi të plotë në lumin Drin | - Përmbytje të zonës përreth lumit | 3500 banorë | E lartë | * * |
| 29. Mungesa e sigurisë së argjinaturës së detit K/11 | - Dëmtimi dhe mungesa investimeve | - Përmbytje nga deti dhe kripëzim të tokës | 4000 banorë | E lartë | * * |
| 30. Mosfunksionim normal i sektorit të peshkimit | Mosfunksionimi i ligjit për peshkimin dhe akuakulturën<br>- Mungesa e kërkesave për zbatimin e tij | Mungesë kontrolli dhe mirëmenaxhimi | 200 veta | E mesme | * * * |
| 31. Mungesa e profesionalizmit në zënien e peshkut | - Mungesa përvoje dhe kualifikimi | - Ulje e rendimentit | 200 veta | E mesme | * * |
| 32. Niveli i ulët teknologjik i flotës së peshkimit | - Anije të vjetra dhe blerje pa kriter | - Mungesë konkurrimi me homologët | 200 veta | E mesme | * * * |
| 33. Mosfunksionim normal i shoqatave të peshkimit | - Organizimi i dobët dhe mungesë interesi | - Prishje e ekuilibrave socialë | 260 veta | E mesme | * * |
| 34. Gjuetia pa kriter në laguna, në kohën e riprodhimit | - Mungesa e një kontrolli rigoroz | - Rrezikim i llojeve | 3500 banorë | E mesme | * * * |
| 35. Gjuetia e paligjshme me mjete plasëse | - Mosfunksionimi i ligjit | - Dëmtim total i gjeneratave | Gjithë konsumatorët | E lartë | * * * |
| 36. Moszbatimi i regjimit hidrik të lagunave | - Mungesa e një njësie të specializuar në këtë drejtim | - Dëmtimi i habitateve të lagunave<br>- Ulje e prodhimit | 200 veta | E mesme | * * |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 37. Dëmtim i sistemit kullues e ujitës | - Mungesë mirëmbajtje e sistemit<br>- Prishje nga ndërtimet apo nga ndërhyrjet pa leje<br>- Nuk janë ruajtur kuotat e thellësisë së kanaleve përkatëse<br>- Rehabilitimi i pjesshëm i kanaleve të para dhe të dyta<br>- Interesi i ulët i fermerëve për pastrimin e kanaleve të treta | - Mbajtje e ujit në sipërfaqe dhe prishje e rregjimit termik. Si rezultat, lënia e tokës djerrë dhe rendimente të ulëta<br>- Rritja e shkallës së përmbytjeve në tokat bujqësore<br>- Mbjellje jashtë afateve biologjike të kulturave bujqësore, ulje rendimenti | 4500 banorë | E lartë | * * * |
| | - Mosfunksionimi i shoqatave për administrimin e ujit | - Mungesë organizimi nga fermerët mbi zhvillimin e teknikave të reja të tregut apo hartimin e politikave në bashkëpunim me aktorët e interesuar.<br>- Ulje e llojshmërisë së kultivarëve dhe krijimi i deficiteve ushqimore për njerëzit dhe blegtorinë | 5000 banorë | E lartë | * * * |
| 38. Ulja e kapacitetit ujëmbajtës të lumit Drin | - Rënia e sasisë së ujërave që nga burimi i tij, për shkak të devijimit<br>- Zgjerim i pjesshëm i tij dhe thellim vetëm në segmente te caktuara | - Përmbytje, pothuaj të përvitshme, dhe depozitim i pakët i inerteve në grykëderdhje<br>- Rritje e erozionit detar, dhe për pasojë, ndryshimi i kripshmërisë së tokave | 4000 banorë | E mesme | * * |
| 39. Përdorim i pakontrolluar i kimikateve dhe i pesticideve në fushë të hapur | - Mosnjohje e ndikimit negativ nga ana mjedisore dhe ekonomike | - Ulje e vlerave tregtare, dhe për rrjedhojë, edhe e çmimit | 1000 banorë | E mesme | * * |
| | - Mosvlerësim në shkallën e duhur të florës dhe të faunës | - Rritje e shkallës së ndotjes në tokë dhe dëmtim i ekosistemeve | 500 banorë | E ulët | * |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | - Mungesa e njohjes së rrezikut për shëndetin e njerëzve | - Krijimi i rezervave, në mënyrë të vazhdueshme në organizmin e njeriut, të helmeve<br>- Ndotje e ujërave në zonat e mbrojtura | 1500 banorë | E ulët | ** |
| 40. Mungesa e tregtimit të prodhimit bujqësor | - Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e tyre | - Ulje e përfitimit ekonomik<br>- Mosinteresim për tokën dhe kultivimin e qëndrueshëm bujqësor2 | 3000 banorë | E mesme | * * |
| 41. Moszhvillimi i tipeve të mundshme të turizmit | - Për shkak të investimeve të pakta | - Ulje e numrit të pushuesve në sezon dhe mosshfrytëzim i burimeve | 15 % | E mesme | * * * |
| 42. Mungesa e menaxhimit të vlerave turistike | - Ndryshime të ngadalta në qëndrimin ndaj menaxhimit | - Ulja e ritmeve të zhvillimit | 5-8 % | E mesme | * * * |
| 43. Mungesa e shumëllojshmërisë së shërbimit turistik | - Mungesë e kualifikimit në të gjitha nivelet | - Ulja e cilësisë së shërbimit | 10 % | E mesme | * * |
| 44. Ndotja e mjedisit nga mbetjet dhe ujrat e zeza | - Ndërgjegjësim i pakët i publikut | - Shtimi i sëmundjeve dhe rritja e shkallës së vdekshmërisë | 3 % | E mesme | * * |
| 45. Mungesa e infrastrukturës (rrugë, energji, ujë i pijshëm) | - Mungesë e investimeve të mjaftueshme, mungesë menaxhimi e fondeve ekzistuese | - Ulja e numrit të pushuesve, ndotja e mjedisit | 10552 banorë | E lartë | * * * |
| 46. Mungesa e qendrave të informimit | - Mosmiratim në strukturën organike | - Mosinformim në kohë mbi vlerat turistike | 15000 banorë dhe turistë | E lartë | * * * |
| 47. Aktivitete të pakta të OJFve | - Mungesë kapacitetesh<br>- Mungesë informacioni | - Ulja e nivelit të jetesës<br>- Ulja e numrit të vizitorëve | 3 % | E mesme | * * |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 48. Dëmtimi i florës dhe i faunës | - Gjuetia ilegale<br>- Menaxhimi i dobët dhe moszbatimi i kuadrit ligjor | - Shfarosja e shpendëve dhe e peshkut, si dhe ulje në prodhimin e pritshëm | 15 % | E mesme | * * |
| 49. Arsimi parashkollor në nivele të ulëta | - Mungesa e mjediseve<br>- Mungesa e pajisjeve | - Ulja e nivelit të nxënësve në fillore | 10 % | E mesme | * * |
| 50. Mospërfshirja e edukimit mjedisor në programet mësimore | - Koncepte jo të drejta në qëndrimin ndaj mjedisit<br>- Mungesa e koordinimit ndërmjet ministrive | - Ndotje e shtuar e mjedisit<br>- Mungesë iniciativash mjedisore | 15 % | E lartë | * * * |

1 Shkalla e prioritarizimit jepet si vijon - *** = I rëndësisë së lartë; ** = I rëndësisë së mesme; * = I rëndësisë së ulët

2 Vlen të theksohet që mbjellja e tokave me të njëjtën bimë për vite me rradhë, çon në degradimin e vlerave ushqyese të saj dhe në varfërimin e përhershwm si tokë bujqësore. Kjo praktikë është ndjekur gjithmonë në vendin tonë, por për shkak të fragmentizimit të tokës, ky fenomen do të vazhdojë të mbetet i tillë dhe çdo ditw e më shqetësues.

# 6. Vlerësimi i mundësive - Rekomandimet



| **Problemi 1: Informaliteti në zhvillimin urbanistik** | |
|---|---|
| Mundësitë:<br>a. Miratimi i planeve të rregullimit të territorit, në përputhje me zhvillimet ekonomike e sociale, aktuale e të ardhshme dhe zbatimi i tyre<br>• lëvizje të studiuara nga zonat rurale për në zonat urbane<br>• zhvillimi i zonave rurale<br>b. Hartimi i planeve të veprimit për ndërhyrje në zonat problematike, të shtrira pa kriter në zonën turistike<br>c. Financimi i infrastrukturës bazë në qytetin e Shëngjinit dhe zgjerimi i tij në hyrje, por edhe duke u fokusuar në zonat periferike rurale, të zhvilluara kohët e fundit: Ishull Shëngjin (lagjja e re), mali i Rencit, mali Shëngjin dhe Ishull Lezhë | |
| Mundësia e parapëlqyer:<br>**Miratimi i planeve të rregullimit të territorit, në përputhje me zhvillimet ekonomike e sociale, aktuale e të ardhshme dhe zbatimi i tyre** | E cila respekton:<br>- Vlerat natyrore<br>- Uljen e varfërisë dhe rritjen e të ardhurave<br>- Zhvillimin e turizmit<br>- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut<br>- Përmirësimin e shëndetit të popullatës |

| **Problemi 2: Mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësorë** | |
|---|---|
| Mundësitë:<br>a. Duhet kryer inventarizimi i burimeve ujore<br>b. Infrastrukturë e re për qytetin e Shëngjinit dhe fshatrat, si dhe riparimi i rrjedhjeve në sistemin aktual<br>c. Evidentimi i lidhjeve të paligjshme, kontrolli ndaj tyre dhe instalimi i matësve të ujit<br>d. Rritja e cilësisë së ujit të pijshëm, duke e vënë atë nën vëzhgimin absolut të sistemit sanitar, si në zonat urbane ashtu edhe në zonat rurale<br>e. Eliminimi i burimeve të hapura të mbetjeve që ndotin ujin<br>f. Plane menaxhuese të administrimit të ujërave nëntokësorë (miradministrimi)<br>g. Duhet ndërtuar dhe zbatuar një program serioz dhe i pandërprerë monitorimi i burimeve ujore, veçanërisht i ujërave nëntokësore<br>h. Duhet plotësuar dhe përmirësuar kuadri ligjor i administrimit të ujit, duke u mbështetur në parimet e mbrojtjes së mjedisit | |
| Mundësia e parapëlqyer:<br>**Infrastrukturë e re për qytetin e Shëngjinit dhe fshatrat, si dhe riparimi i rrjedhjeve në sistemin aktual** | E cila respekton:<br>- Vlerat natyrore<br>- Uljen e varfërisë dhe rritjen e të ardhurave<br>- Zhvillimin e turizmit<br>- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut<br>- Përmirësimin e shëndetit të popullatës |

| Problemi 3: Mungesa e kushteve të përshtatshme të punës dhe e hapjes së vendeve të reja të punës | |
|---|---|
| Mundësitë:<br>a. Lehtësimi i procedurave për hapjen e bizneseve të reja<br>b. Zbatimi i programeve të kualifikimit, nëpërmjet punësimit<br>c. Stimulimi i bizneseve për çdo të punësuar shtesë<br>d. Zhvillimi i bujqësisë, i turizmit bregdetar dhe atij etnokulturor<br>e. Mundësia e punësimit me përparësi të banorëve të Shëngjinit në ndërmarrjet e mëdha, që kryejnë aktivitetin brenda territorit të komunës<br>f. Garantimi i barazisë në tregun e punës mes gruas dhe burrit<br>g. Sigurimi i kushteve të përshtatshme në punë | |
| Mundësia e parapëlqyer<br>**Zhvillimi i bujqësisë, i turizmit bregdetar dhe atij etnokulturor** | E cila respekton:<br>- Vlerat natyrore<br>- Uljen e varfërisë dhe rritjen e të ardhurave<br>- Zhvillimin e turizmit<br>- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut<br>- Përmirësimin e shëndetit të popullatës |

| Problemi 4: Rritje e shtuar e trysnisë njerëzore mbi mjedisin fizik nga imigrimi i brendshëm në drejtimin fshat – qytet | |
|---|---|
| Mundësitë:<br>a. Mundësia për të rritur shkallën e punësimit, si dhe organizimi i procedurave të lehta për krijimin e bizneseve<br>b. Rritja e pagave, kushte më të mira pune, kushte më të mira në shërbimin arsimor dhe shëndetësor, stabilitet në siguri dhe rend<br>c. Krijimi i mundësive për një migracion të kontrolluar nga shteti<br>d. Strategji e qartë zhvillimi për zonat rurale:<br>• Përmirësimi i infrastrukturës rrugore, arsimore, shëndetësore, ujësjellës etj.<br>• Politika favorizuese nga shteti për zonat rurale në kredi etj.<br>• Stimulimi financiarisht i kapaciteteve që punojnë në zonat rurale<br>• Lëvizje të studiuara dhe të organizuara, sipas masterplaneve të zhvillimit | |
| Mundësia e parapëlqyer<br>**Strategji e qartë zhvillimi për zonat rurale, të cilat do të bazohen në pjesëmarrje të gjerë komuniteti dhe në mundësitë reale për zhvillim vendor** | E cila respekton:<br>- Vlerat natyrore<br>- Uljen e varfërisë dhe rritjen e të ardhurave<br>- Zhvillimin e turizmit<br>- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut<br>- Përmirësimin e shëndetit të popullatës |

| Problemi 5: Ndërgjegjësimi i banorëve në një shkallë të ulët |
|---|
| Mundësitë:<br>a. Angazhim i autoriteteve vendore, por dhe i aktorëve të tjerë në:<br>- Ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me administrimin urban<br>- Ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me ruajtjen e cilësisë se tokës<br>- Ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me menaxhimin e ujit të pijshëm<br>- Ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me marrjen pjesë në hartimin e politikave, planet e zhvillimit, në monitorime dhe në VNM |

| Mundësia e parapëlqyer | E cila respekton: |
|---|---|
| **Ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me pjesëmarrjen për hartimin e politikave dhe në planet e zhvillimit për monitorime dhe në VNM** | - Vlerat natyrore<br>- Uljen e varfërisë dhe rritjen e të ardhurave<br>- Zhvillimin e turizmit<br>- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut<br>- Përmirësimin e shëndetit të popullatës |

| **Problemi 6: Mungesë e një sistemi menaxhimi i mbetjeve urbane, shoqëruar me ndotje të lartë të mjedisit** | |
|---|---|
| Mundësitë:<br>a. Hartimi i një studimi për caktimin e një vendi për grumbullimin e mbetjeve për një periudhë shumëvjeçare dhe larg zonave të banuara, si dhe larg zonës turistike<br>b. Ndërgjegjësimi i publikut për dëmet që shkakton hedhja e mbetjeve pa kriter dhe jashtë vendeve të përcaktuara<br>c. Kalimi i sektorit të pastrimit të qytetit në ndërmarrje private | |
| Mundësia e parapëlqyer<br>**Hartimi i një studimi për caktimin e një vendi për grumbullimin e mbeturinave për një periudhë shumëvjeçare dhe larg zonave të banuara dhe zonës turistike** | E cila respekton:<br>- Vlerat natyrore<br>- Uljen e varfërisë dhe rritjen e të ardhurave<br>- Zhvillimin e turizmit<br>- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut<br>- Përmirësimin e shëndetit të popullatës |

| **Problemi 7: Sistemet e kanalizimeve të ujërave të zeza të dëmtuara dhe të keqmenaxhuara** | |
|---|---|
| Mundësitë:<br>a. Hartimi i projekteve të plota për sistemimin dhe kanalizimin e ujërave të zeza të qendrave të banuara, si dhe shkarkimi i tyre në një qendër të kontrolluar, si ai i ligatinave në Ishull Shëngjin<br>b. Mirëmbajtja e sistemit ekzistues të kanalizimeve të ujërave të zeza. | |
| Mundësia e parapëlqyer<br>**Hartimi i projekteve të plota për sistemimin dhe kanalizimin e ujërave të zeza të qendrave të banuara dhe shkarkimi i tyre në një qendër të kontrolluar, siç është ai i ligatinave në Ishull Shëngjin** | E cila respekton:<br>- Vlerat natyrore<br>- Uljen e varfërisë dhe rritjen e të ardhurave<br>- Zhvillimin e turizmit<br>- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut<br>- Përmirësimin e shëndetit të popullatës |

| **Problemi 8: Ndotje e lartë e mjedisit dhe e sistemit hidrik, si shkak i derdhjes së mbetjeve teknologjike nga industria** |
|---|

| Mundësitë:<br>a. Ndërtimi i impianteve bashkëkohore të pastrimit të ujit teknologjik, që del nga përpunimi i peshkut, si dhe rritja e përgjegjësisë së organeve të kontrollit higjieno-sanitar e mjedisor mbi këto pika përpunimi<br>b. Përcaktimi i një vendi të veçante për hedhjen e mbeturinave të ngurta të përpunimit të peshkut | |
|---|---|
